

RAPORTI I MONITORIMIT TË GJYKATAVE 2014





Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e BIRN-it dhe Internews Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk përmban pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese dhe Internews Kosova, Prishtinë, Prill 2015.

Mendimet e shprehura në këtë dokument nuk paraqesin medoemos mendimet e donatorëve të Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese dhe të Internews Kosova, stafit, bashkëpunëtorëve apo Bordit të tyre. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti pa leje paraprake. Kontaktoni me zyrën administrative të Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese apo Internews Kosovës për kërkesa të tilla.

Botuar nga:



“Mensa e Studenteve” Kati i parë,
Prishtinë 10 000, Kosovë
Website: www.kosovo.birn.eu.com
www.internewskosova.org
Email: kosova@birn.eu.com
info@internewskosova.org



INTERNEWS KOSOVA

**RAPORTI I MONITORIMIT
TË GJYKATAVE
2014**

AUTORE E RAPORTIT:

Furtuna Sheremeti

BASHKË-AUTOR:

Petrit Kryeziu, Skender Govori, Labinot Leposhtica dhe Fitore Metbala

RAPORTIT I KONTRIBUAN:

Kreshnik Gashi dhe Armend Zenelaj

Faik Ispahiu

Menaxher i projektit të Monitorimit të Gjykatave dhe Drejtor Ekzekutiv i Internews Kosova

MONITORUES:

Petrit Kryeziu

Qazim Hasanaj

Leke Muqaj

Armend Zenelaj

Behar Mustafa

Labinot Leposhtica

Skender Govori

Ardian Lulaj

PËRMBAJTJA

I. HYRJE	6	a. Me apo pa telefon?	14	5. Probleme tjera në pallat	25
II. METODOLOGJIA	7	b. Me apo pa uniformë?	15	C. SHKELJET PROCEDURALE	26
1. Monitorimit të seancave të rregullta	7	5. Dokumentimi dhe arkivimi i seancave gjyqësore	17	D. KU? KUSH? PSE? Specifika rastesh	27
2. Analizës së vendimit të Gjykatës Kushtetuese	7	a. Me apo pa audio/video incizim	17	IV. NUMRI I GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE	34
3. Bench Bars	7	b. Me apo pa deklarata? Me apo pa udhëzime?	18	V. VENDIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE QË NGJALLI DISKUTIME	39
III. MONITORIMI I GJYKATAVE TË RREGULLTA	8	6. Pajisja teknike e gjykatave	19	VI. BENCH BARS (Tryezat e Rrumbullakëta)	49
A. SHKELJET TEKNIKE	8	B. PALLATI I DREJTËSISË SI SHPRESË PËR PËRMIRËSIM	21	VII. VËZHGIMET POZITIVE NGA GJYKATAT	51
1. Lajmërimi i seancave gjyqësore Me apo pa transparencë?	8	1. Lokacioni i Ndërtimit të Objektivit	22	VIII. APLIKIMI I REKOMANDIMEVE NGA VITI I KALUAR	52
2. Fillimi i seancave gjyqësore Me apo pa vonesë?	10	2. "Drejtësia Afër Qytetarit"	23	A. Zbatimi i masave alternative për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale	55
3. Mbajtja e seancave gjyqësore në sallë apo jashtë saj?	13	3. Akomodimi i Stafit në Pallat	24	IX. REKOMANDIME dhe FALËNDERIME	56
4. Normat elementare të disiplinës në punë	14	4. 28 Salla të Gjykimit	25		

I. HYRJE

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese për të tetin vit me radhë ka vazhduar me monitorimin e procedurave gjyqësore në Gjykatat Themelore, të Apelit dhe atë Supreme. Këtë vit për të parën herë është përfshirë në Raport edhe Gjykata Kushtetuese – ku do të prezentohet analiza juridike e përgatitur nga ekipi i juristëve monitorues.

Viti 2014 ka qenë viti i dytë në të cilin gjykatat dhe prokuroritë kanë aplikuar organizimin e ri strukturor dhe dispozitat dhe procedurat e reja penale.

Në vitin 2013 i cili ka qenë viti pilot i organizimit të ri strukturor të gjykatave, monitorimi ynë ka identifikuar mungesa dhe shkelje të ndryshme në proceset procedurale ligjore, teknike deri tek ato etike. Ndërkaq viti 2014 si viti i dytë i ndryshimeve strukturore, ka qenë shans i mirë për gjykatat që të përmirësojnë performansën e tyre.

Megjithatë, përkundër këtij fakti, kemi vërejtur vazhdimësi të shkeljeve teknike dhe procedurale gjatë seancave gjyqësore. Mos-lajmërimi i duhur i seancave gjyqësore, fillimi me vonesë i tyre, përdorimi i telefonave gjatë seancës janë vetëm disa nga shkeljet teknike të evidentuara edhe gjatë vitit 2014, të cilat do të adresohen në pjesën e parë të raportit. Për adresimin sa më korrekt të kësaj çështjeje, kemi vazhduar me një analizë të asaj nëse Pallati i Drejtësisë do të ndihmojë në zgjidhjen e ndonjë prej problemeve teknike.

Në pjesën e dytë të raportit ndërkaq do të trajtohen shkeljet procedurale duke filluar nga procedimi i provave të papranueshme nga Prokuroria e deri te mos-leximi i aktakuzës në shqyrtimin fillestar, për të vazhduar me analizën e bërë në mes të numrit aktual të gjyqtarëve e prokurorëve dhe numrit që do të duhej të ekzistonte që sistemi të funksiononte më mirë.

Pjesa e tretë përfshinë një risi që këtë vit prezentohet në raportin e monitorimit e që ka të bëjë me Gjykatën Kushtetuese. Kjo pjesë është ndarë për analizën ligjore të bërë në lidhje me Aktvendimin për Papranueshmëri të nxjerrë nga Gjykata Kushtetuese në Kërkesën e Institucionit të Avokatit të Popullit për vazhdimin e mandatit të tre gjykatësve ndërkombëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Në të katërtën pjesë do të paraqitet një risi tjetër e që ka të bëjë me monitorimin e “Bench Bareve” apo Tryezave të Rrumbullakëta të organizuara nga Oda e Avokatëve të Kosovës. Diskutimet në këto tryeza kanë trajtuar shumë nga çështjet e ngritura në raportet e BIRN-it nga monitorimi i gjykatave, duke e ngritur diskutimin në një spektër më të gjerë duke përfshirë avokatë, gjykatës, prokurorë e zyrtarë policorë.

Raporti përfundon me vëzhgimet pozitive nga gjykatat dhe rekomandimet e nxjerra nga monitorimi i bërë përgjatë gjithë vitit 2014.

II. METODOLOGJIA

Këtë vit, metodologjia e përdorur gjatë monitorimit përbëhet prej:

1. **Monitorimit të seancave të rregullta:** Për monitorimin e seancave të rregullta është përdorur metoda e vëzhgimit në gjykatore dhe plotësimin të pyetësorëve si rezultat i vëzhgimit.
2. **Analizës së vendimit të Gjykatës Kushtetuese:** Tek kjo pjesë është analizuar Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese për rimërimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës Kushtetuese.
3. **Bench Bars¹:** Për monitorimin e Bench Bars është përdorur gjithashtu metoda e vëzhgimit dhe shkrimit të raporteve si rezultat i vëzhgimit.

Monitorimi ka mbuluar gjykatat e rregullta në 26 komuna të Kosovës (Themelore, Apelit dhe Supreme).

Ky raport bazohet në 501 pyetësorë të plotësuar gjatë vitit 2014 nga të cilat, 426 seanca janë mbajtur, ndërsa 75 seanca gjyqësore të monitoruara nuk janë mbajtur.

Duke përfshirë 501 seancat e monitoruara gjatë vitit 2014, numri i përgjithshëm i seancave të monitoruara në projektin e monitorimit të gjykatave ka arritur në 9,195, duke krijuar një mostër të besueshme dhe një bazë të fuqishme të të dhënave në të cilat bazohen dhe në mënyrë komparative analizohen rezultatet dhe gjetjet e projektit.



¹ Bench Bars janë tryeza të rumbullaktë të organizuara nga Oda e Avokatëve të Kosovës të cilat mbledhin rreth vetes avokatë, gjykatës, prokurorë e policë për të diskutuar rreth problemeve në gjyqësor.

III. MONITORIMI I GJYKATAVE TË RREGULLTA

Gjatë vitit 2014 ekipi i monitoruesve të BIRN ka monitoruar gjykatat e rregullta (ato Themelore, Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme) në tërë territorin e Kosovës.

Qytetet në të cilat kemi monitoruar janë:

Prishtina, Prizreni, Peja, Mitrovica, Gjlani, Ferizaji, Vushtrria, Skenderaji, Drenasi, Kacaniku, Vitia, Podujeva, Rahoveci, Suhareka, Klina, Istogu, Gjakova, Decani, Dragashi, Lipjani, Kamenica, Novoberda dhe Malisheva.

A. SHKELJET TEKNIKE

Njëri ndër qëllimet e monitorimit të bërë nga monitoruesit e BIRN qysh prej vitit 2008, ka qenë dhe mbetet adresimi i problemeve teknike të cilat siç është vërtetuar në shumë raste, hapin rrugë për probleme të tjera.

Konsiderojmë se situata në sektorin sundimit të ligjit do të vazhdojë të qëndrojë problematike përderisa të tolerohen shkelje teknike, të cilat edhe pse janë lehtë të evitueshme dëshmojnë mungesën e gatishmërisë për veprime konkrete drejt përmirësimit së situatës së gjithmbarshme.

Probabiliteti që diçka të shkojë proceduralisht jo në rregull është shumë më i madh nëse p.sh. telefonat përdoren gjatë seancave gjyqësore – gjë që ndikon drejtpërdrejtë në humbjen e koncentrimin, ose nëse gjykimet mbahen në zyrë të gjykatës në vend se të mbahen në sallë të gjykimin. Për derisa tolerohen shkelje të vogla, do të jetë e vështirë që të luftohen edhe shkeljet e mëdha. Shkeljet teknike shpeshherë kanë qenë dhe mbeten rruga e shtruar drejt shkeljeve procedurale.


Për këto dhe arsye të tjera të shumta, kemi vendosur që edhe këtë vit të vazhdojmë me monitorimin e seancave gjyqësore në gjykatat e rregullta dhe të shohim se a ka pasur shkelje teknike – dhe nëse po – çfarë shkeljesh janë bërë dhe si mund të adresohen ato që të përmirësohet gjendja vitin e ardhshëm.

1. Lajmërimi i seancave gjyqësore Me apo pa transparencë?

Edhe në këtë vit sikur në vitin e kaluar, seancat kanë vazhduar të lajmërohen në tabelën e shpalljeve dhe përmes internetit – në ueb faqet e gjykatave. Raportet tona të vitit 2012 kanë tërhequr vërejtjen se ueb faqet shfrytëzoheshin vetëm për lajmërimin e seancave të EULEX-it, në vitin 2013 është parë një përmirësim i dukshëm, që ka shtyrë që në Raportin e Monitorimit të 2013 – të identifikohet një gjyqësor më transparent sa i përket lajmërimin të seancave².

Ndërkaq sa i përket vitit 2014, nga tërësia e seancave gjyqësore të monitoruara, 82% e tyre kanë qenë të lajmëruara duke lënë kështu vetëm 18% të seancave pa lajmëruar. Nga 82% të seancave të lajmëruara, 63% kanë qenë të lajmëruara në tabelën e shpalljeve, ndërkaq 19% në ueb-faqe.

Në tabelën në vazhdim, është pasqyruar përqindja e seancave të monitoruara – mbajtura, atyre që kanë qenë të lajmëruara dhe atyre të cilat nuk kanë qenë të lajmëruara, para fillimit të shqyrtimit:



Vitin e kaluar përqindja e seancave të palajmëruara ishte 22%, ndërkaq këtë vit ka rënë në 18% që do të thotë se vihet re përmirësim i vogël në këtë aspekt. Krahasuar me vitin e kaluar përqindja e lajmërimit të seancave në ueb-faqe mbetet e njejtë (21% në vitin 2013 dhe 2014) ndërkaq lajmërimi i seancave në tabelën e shpalljeve rritet nga 57% sa ka qenë për periudhën e njejtë kohore në 2013 - në 63% në vitin 2014.

Megjithatë dallimi i përqindjes në mes të seancave të lajmëruara në ueb-faqe dhe atyre të lajmëruara në tabelën e shpalljeve është i madh dhe si i tillë paraqet shqetësim. Sado që rritja e përqindjes së seancave të lajmëruara në tabelën e shpalljeve mund të konsiderohet

si e arritur e këtij viti – kjo e arritur përcillet me shqetësimin e mos-lëvizjes së përqindjes së lajmërimit të seancave në ueb-faqe. Ky është një prej shqetësimeve që sjell monitorimi ynë këtë vit, bashkë me paralajmërimin për nevojën urgjente të digjitalizimit të Gjykatave dhe funksionalizimit të ueb-faqeve në përgjithësi – e për lajmërimin e seancave në veçanti.

Trajektorja e matjeve të BIRN prej vitit 2010 e deri në vitin 2014 sa i lajmërimit të seancave gjyqësore në tabelën e shpalljeve – duket si më poshtë:



Gjithashtu lidhur me Gjykatën themelore në Prishtinë, departamentin e krimeve të rënda, oraret e gjykimeve nuk janë të shpallura në monitor asnjëherë, dhe informimi lidhur me mbajtjen e seancave mund të bëhet vetëm përmes burimeve tjera siç është për shembull komunikimi me avokatët e rasteve.

Po ashtu në Prishtinë në të njëjtën Gjykatë, është e shprehur në masë të madhe mbajtja e Gjykimeve në zyra të Gjykatësve, ku ndonjëherë numri i madh i të akuzuarve dhe palëve ka përjashtuar parimin e transparencës.

Fatkeqësisht ka raste kur lajmërimi i seancave nuk bëhet as në tabelën e shpalljeve e as në ueb-faqe. Sidomos kur vije fjala tek Gjykata Themelore në Prishtinë – DKR, as edhe për një seancë nuk bëhet lajmërimi (shqyrtimi gjyqësor me P.nr 363/12, shqyrtimi me P.nr 330/12 i mbajtur me 5 dhjetor 2014, shqyrtimi me P.nr 583/14 i mbajtur me 2 dhjetor 2014). I njëjti problem ekziston edhe në Gjykatën


Themelore në Pejë ku lajmërimi i seancave në tabelë nuk bëhet me arsyetimin se monitorët nuk funksionojnë.

2. Fillimi i seancave gjyqësore Me apo pa vonesë?

Në vitin e kaluar kemi raportuar se 27% e seancave gjyqësore kishin nisur me vonesë, ndërkaq arsyeja më e shpeshtë e mos-fillimit në kohë të seancave ishte trupi gjykues.

Këtë vit përqindja e mos-fillimit me kohë të seancave ka rënë për 4%. Për dallim prej vitit të kaluar kur 27% e seancave kishin filluar me vonesë – këtë vit me vonesë kanë filluar 23% e tyre.

Tabela në vijim, pasqyron seancat gjyqësore që kanë filluar më kohe dhe ato që kanë filluar më vonesë gjatë vitit 2014:




Ndërkaq, akterët për vonimet e shkaktuara janë nga më të ndryshmit. Ata variojnë prej trupit gjykues, prokurorëve, avokatëve, dëshmitarëve, probleme me përkthimin, zgjatja e seancës paraprake e të tilla. Megjithatë, përqindje konsiderueshëm të lartë të kjo pikë ka trupi gjykues (54%).

pas vonohen prokurorët (14%) dhe avokatët (8%) dhe si pasojë e kësaj seancat nuk mund të fillojnë në kohë. Ndërkaq vonesa e dëshmitarëve dhe probleme me transportin zënë nga 2% në tërësinë e përgjithshme të përqindjeve dhe duket se paraqesin problemet më të vogla në këtë aspekt.

Arsyeja kryesore e mos-fillimit në kohë të seancave gjyqësore vërehet të jetë vonesa e trupit gjykues – edhe këtë vit. Menjëherë pas trupit gjykues - vërehet se më së shumti më

Në tabelën në vijim, janë pasqyruar shifrat të cilat tregojnë arsyet e vonesës së fillimit të shqyrtimit gjyqësor:




Përgjatë të gjitha viteve të monitorimit, arsyeja kryesore e vonimit të seancave gjyqësore gjegjësisht mos-fillimit të tyre në kohë, ka qenë vonesa e trupit gjykues.

Për dallim prej vitit të kaluar, këtë vit shifrat janë më shqetësuese. Nga 50% vonesa të shkaktuara nga trupi gjykues vitin e kaluar-këtë vit 54% e vonesave janë shkaktuar nga vonesa e trupit gjykues. Prokurorët përcjellin me 15% të vonesave, ndjekur nga avokatët me 8%. Palët janë vonuar në 6% të seancave të monitoruara, përderisa përkthyesit, dëshmitarët, transporti i ShKK dhe PK kanë përqindje më të ulët se 5% në vonesën e seancave gjyqësore të monitoruara.

Në vazhden e përpjekjeve tona për ngritje të zërit rreth çështjeve të rëndësishme, vonesat e seancave gjyqësore gjithmonë kanë zënë vend kyq. Rritja e përqindjes kur është fjala për arsyen e mos-fillimit në kohë të seancave gjyqësore – duhet të shihet si nevojë urgjente e ndërmarrjes së masave në lidhje me vonesat e trupit gjykues.

Trajektorja e matjeve tona prej vitit 2010 e deri në vitin 2014 sa i përket fillimit me kohë të seancave gjyqësore – duket si më poshtë:



Sa i përket kësaj pike, kjo shkelje teknike ka qenë mjaft evidente gjatë monitorimit tonë. Në Gjykatën Themelore të Prishtinës – DP, shqyrtimi gjyqësor me 12 dhjetor 2014 ishte i lajmëruar se do të mbahej në ora 9:00, i njëjti filloi me 55 minuta vonesë. Po ashtu kemi identifikuar edhe raste tjera në Gjykatën themelore në Prishtinë si: me 8 nëntor 2014 në shqyrtim seanca filloi 20 minuta me vonesë, ndërsa shqyrtim gjyqësor i mbajtur me 2 dhjetor 2014 filloi 1 orë me vonesë.

Gjykimi i mbajtur në gjykatën themelore Suharekë për lëndën Kompensim dëmi filloi 15 min me vonesë për shkak të vonesës së të paditurit. Pritja e të paditurit u bë në koordinim me paditësit.

Po ashtu në shqyrtimin e mbajtur me 10.06.2014 në çështjen civile Vërtetim pronësie, shqyrtimi filloi me vonesë për 1 orë e 5 min, për shkak të vonesës së avokatit, pasi i njëjtit ishte në një shqyrtim tjetër.

Shqyrtimi i mbajtur në gjykatën themelore në Suharekë me 26.11.2014 me numër Pnr-165/13 në çështjen penale Lëndim i lehët trupor, seanca e paralajmëruar që të fillojë në ora 10, filloi një orë me vonesë, për shkak të vonesës së prokurores pasi e njëjta ishte në shqyrtim te gjykatësi tjetër. Palët priten në sallën e gjykimit 1 orë deri sa erdhi prokuroja nga shqyrtim tjetër.

Në seancën gjyqësore me numër të lëndës P.nr.171/13 të cilët po akuzohen për kryerje të veprave penale të Keqpërdorimit të detyrës dhe autoritetit zyrtar, seanca gjyqësore filloi me 10 minuta vonesë, për shkak të vonesës së trupit gjykues, arsyet e vonesës nuk u komentuan nga ky i fundit!


Në lëndën e zbulimit të fshehtësisë zyrtare nga neni 433 par. 1 i KPK-së, seanca gjyqësore me numër të lëndës P.nr. 440/13 filloi me 40 minuta vonesë, për shkak të vonesës së avokatit, i cili e kishte njoftuar trupin gjykues se ishte i angazhuar në një seancë tjetër të vrasjes, në po të njëjtën gjykatë.

Prej të gjitha seancave të monitoruara gjatë vitit 2014 – në asnjë rast nuk është shqiptuar asnjë dënim për këto vonesa – edhe kur ato nuk janë arsyetuar.

3. Mbajtja e seancave gjyqësore në sallë apo jashtë saj?

Vendi i mbajtjes së seancave gjyqësore në vazhdimësi ka qenë objekt i interesit të monitorimit të BIRN – përgjatë viteve për shkak se ndër vite shumë seanca gjyqësore janë mbajtur nëpër zyre të gjyqtarëve në vend se të mbahen në sallat e gjykimit.

Sipas të dhënave që dalin nga monitorimi ynë – del se në 80% të rasteve seancat gjyqësore janë mbajtur në sallën e gjykimit, ndërkaq 15% e tyre janë mbajtur në zyre të Gjykatësit, kurse 5% në vende tjera siç janë objektet me qira që i ka marrë gjykata.



4. Normat elementare të disiplinës në punë

Për të parë nëse trajektorja e disiplinës i shpion gjykatësit në objektivizëm dhe pavarësi të plotë, kemi monitoruar përdorimin e telefonave mobil dhe uniformave gjatë seancave gjyqësore.

Sa i përket normave disiplinore dhe raportimit të tyre, BIRN ka pasur raste të shumta të cilat i ka paraqitur tek instancat e duhur ligjore siç janë rastet e shkeljeve disiplinore të gjykatësit që ka publikuar mbështetje politike në rrjete sociale³, shkeljet e mundshme disiplinore tek rasti i Vonesa Topallit ku përjashtohet nga përgjegjësia njëri nga të dyshuarit e rastit, shkeljet e mundshme disiplinore tek (mos) pagesa e taksave në gjykatën e Klinës⁴, shkelet penale tek rasti i rrjedhjes së mesazheve në prokurorinë e Gjakovës⁵, shkeljet e mundshme disiplinore gjatë zvarritjes së rastit të Skender Sinës⁶ e shumë të tjera. Raportimi i këtyre rasteve tregon seriozitetin me të cilin BIRN i


trajton normat disiplinore dhe përkushtimin me të cilin i kemi trajtuar në këtë raport.

a. Me apo pa telefon?

Edhe gjatë këtij viti – BIRN ka vazhduar me monitorimin e përdorimit të telefonave gjatë seancave të monitoruara gjyqësore. Përgjegjësia e kryetarit të trupit gjykues apo vet gjykatësit të çështjes edhe këtë vit vazhdon të mos jetë shumë e kënaqshme kur vie te sigurimi i mbarëvajtjes së gjykimeve pa përdorimin e telefonave në shqyrtimin gjyqësor.

Duke qenë se gjatë seancave gjyqësore – prezentë janë palë të ndryshme, duke nisur nga trupi gjykues/gjyqtari individual, avokatët, prokurorët, policia dhe publiku, monitorimi i përdorimit të telefonave është bërë për të gjithë.

Të gjeturat tona tregojnë se në 93% të rasteve telefoni nuk është përdorur fare nga



³ <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,8322>

⁴ <http://www.drejtisianekosove.com/sq/Emisione/Avullimi-i-taksas-gjyqesore-ne-Kline-1252>

⁵ <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,9196>

⁶ <http://www.drejtisianekosove.com/sq/Emisione/Ryshfeti-ne-Gjakove-1068>

askush ndërkaq 7%-i tjetër ndahet në mes të avokatëve të cilët kanë përdorur telefonat në 2% të rasteve, prokurorëve të cilët poashtu kanë përdorur telefonat në 2% të rasteve, trupi gjykues të cilët gjithashtu kanë përdorur telefonat në 2% të rasteve dhe policisë - pjesëtarët e të cilës kanë përdorur telefonat në vetëm 1% të rasteve. Ndërkaq sipas të dhënave

të monitorimit tonë – rezulton se publiku në asnjë nga seancat e monitoruara nuk ka përdorur telefonat asnjëherë.

Trajektorja e matjeve tona prej vitit 2010 e deri në vitin 2014 sa i përket përdorimit të telefonave gjatë seancave gjyqësore – duket si më poshtë:




b. Me apo pa uniformë?

Në vitin 2013-të Këshilli Gjyqësor i Kosovës miratoi vendimin me të cilin autorizonte blerjen e uniformave për gjykatësit e tri niveleve të gjykatave konform dizajnit të miratuar paraprakisht nga anëtarët e KGJK-së. Projekti i blerjes së uniformave për gjykatës i kushtoi KGJK rreth 45 mijë euro. Si rrjedhojë e këtij vendimi të gjithë gjykatësit u pajisën me uniforma të reja dhe si rrjedhojë të gjithë në gjykatore obligohen ta bartin uniformën.


Megjithkëtë BIRN ka vërejtur se të njëjtin veprim nuk e ka bërë Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe si rrjedhojë shumë prokurorë për momentin nuk janë të pajisur me uniforma. Por, shqetësuese vazhdojnë të mbesin rastet kur gjykatësit edhe pse janë të pajisur me uniforma vendosin të mos i bartin ato. Përderisa në vitin 2013, BIRN ka identifikuar se në 34% të rasteve,

uniformat nuk janë përdorur nga askush, në 16% janë përdorur pjesërisht (vetëm nga gjykatës, prokurori apo avokati) dhe në 50% të gjykimeve të monitoruara, uniformat janë përdorur nga të gjithë, në vitin 2014 vërehet se gjërat janë përmirësuar sadopak në këtë aspekt.

Prej 34% sa ka qenë përqindja e mos-përdorimit të uniformave nga askush në vitin 2013, ka rënë në 4% këtë vit. Megjithatë duhet pasë parasysh se kjo përqindje është për rastet kur asnjë person në gjykatore nuk ka përdorur uniformën. Në 22% të rasteve uniformat nuk janë përdorur nga të gjithë, që do të thotë se janë përdorur ose vetëm nga trupi gjykues, ose vetëm nga prokurori ose avokati. Në 22% të rasteve nuk ka pasur konsistencë të përdorimit të tyre. Ndërkaq, vetëm në 4% të rasteve uniformat nuk janë përdorur nga askush. Këtë vit, uniformat janë përdorur në 78% të rasteve.



Në krahasim me vitet e kaluara, edhe përdorimi i uniformave ka shënuar rritje e cila është e pasqyruar si në tabelat me poshtë:



Duke u bazuar në komentet e marra nga avokatët, gjyqtarët e prokurorët – konsiderojmë se prania e monitoruesve nëpër

seancat e monitoruara gjyqësore – ka ndikuar konsiderueshëm në rritjen e përqindjes së përdorimit të uniformave.


5. Dokumentimi dhe arkivimi i seancave gjyqësore

Dokumentimi dhe arkivimi është proces shumë i rëndësishëm, në veçanti kur kemi të bëjmë me seanca gjyqësore ku paraqiten deklarata të palëve të ndryshme dhe versione të ndryshme të të njëjtës histori. Për këtë arsye, edhe këtë vit BIRN ka monitoruar nëse seancat janë incizuar e xhiruar dhe nëse deklaratat e palëve janë marrë në mënyrën e duhur.

a. Me apo pa audio/video incizim

Mos-shfrytëzimi i mundësisë për incizim të seancave gjyqësore – e cila përcaktohet edhe


me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës⁷ përkundër faktit që është dyfishuar nga viti i kaluar, prapëseprapë nuk është në nivelin e duhur. Përderisa në vitin 2013 – vetëm 8% e seancave ishin incizuar, këtë vit prej të gjitha seancave të përcjella nga monitoruesit e BIRN – audio-video incizimi është bërë në 15% të rasteve përkundër faktit që gjykatat kanë përgatitje teknike për ta bërë atë. Është mëse e qartë që ka përmirësime por fakti që audio/video incizimi i seancave bëhet vetëm në 15% të rasteve shpie në mos-përfilljen e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës në 85% të rasteve.



Sado që trendi i incizimit të seancave është rritur përgjatë viteve, përqindja e rritjes është aq e vogël sa që nuk mjafton që të konsiderohet si përmirësim, për arsye se është konsiderueshëm më e madhe brenga për rritjen e ngadalshme

të përqindjes sesa entuziazmi për rritjen e saj në rend të parë. Më poshtë, do të analizojmë se si është realisht situata nëpër gjykatat tona sa i përket pajisjeve të nevojshme për audio/video incizim të seancave.

7 Neni 208 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës




b. Me apo pa deklarata?

Me apo pa udhëzime?

Marrja e deklaratave të dëshmitarëve dhe të akuzuarve në mënyrë të duhur gjithashtu bën pjesë në pjesën e dokumentimit të duhur të seancave gjyqësore. Kjo sepse, me marrjen e këtyre deklaratave të cilat mund të lexohen nga palë të ndryshme më vonë – dokumentohet një proces - nëse ka shkuar në rregull apo jo. E njëjta vlen edhe për udhëzimin e palëve në procedurë. Duhet sqaruar që me marrjen e


deklaratave në mënyrë të rregullt nënkuptojmë leximin e të drejtave të dëshmitarit, njoftimin e tij me të drejtat e tij/saj, dërgimin e ftesave me kohë e të ngjashme.

Gjatë vitit 2014 pjesa e marrjes së deklaratave në mënyrë të rregullt apo jo – ka qenë një prej pikave kryesore ku gjykatat kanë treguar përmirësim. Prej të gjitha rasteve që monitoruesit e BIRN i kanë përcjellur këtë vit, në vetëm 2% të rasteve - deklaratat nuk janë marrë në mënyrë të rregullt.



Megjithatë, qëllimi është që deklaratat të merren gjithmonë në mënyrën e duhur dhe të shohim përmirësim derisa përqindja e marrjes së deklaratave në mënyrë jo të rregullt do të duhej të ishte 0.

Ndërkaq, udhëzimi i palëve në procedurë duket se është përmirësuar dukshëm, meqenëse këtë vit – palët nuk janë udhëzuar drejt' në vetëm 1% të rasteve.



6. Pajisja teknike e gjykatave

Digjitalizimi dhe pajisja teknike e institucioneve, është një reformë e domosdoshme, e cila në mënyrë direkte do të përmirësonte performancën e tyre dhe përmbushjen e nevojave për rezultate precize, të shpejta dhe korrekte në këtë periudhë të zhvillimit të shpejtë të teknologjisë. Gjykatat si një shtyllë bazë e çdo shteti, pashmangshëm e kanë të nevojshme pajisjen teknike të tyre, meqë qëllim përfundimtar i tyre është korrektësia dhe mosvonesa e procedurave. Duke patur mjetet e nevojshme teknike në sallat dhe gjykatoret e gjykatave, shmanget vonesa, paqartësitë, krijohet një sistem më i qasshëm, shmangen gabimet në procesverbale nëse seancat xhirohen me audio-incizim, pra minimizohet mundësia e gabimeve dhe keqpërdorimeve që mund të mos vëreheshin e të toleroheshin.

Përveç sfidës me të cilën përballen gjykatat për pajisjen e tyre me mjete teknike, një

tjetër dukuri negative që është ndeshur në monitorimin e bërë është mospërdorimi i po këtyre pajisjeve që do të kontribuonin në transparencë dhe përmirësim të punës në po këto gjykata. Përderisa disa nga gjykatat nuk janë të pajisura me mjete shumë të nevojshme, të tjerat i shmangen përdorimit të tyre, duke i lënë të amortizohen dhe të dalin jashtë funksionit të tyre. Është cekur edhe në raportet e mëparshme që audio-incizimi i seancave është shumë i dobishëm, sepse duke patur të dokumentuara gjithë rrjedhën procedurale të seancës dhe deklaratat në mënyrë digjitale, mundëson në rast nevojë përdorim më efikas në material të pandërhyrë të gjithë asaj që është thënë, konstatuar, vërtetuar dhe dëshmuar gjatë seancës.

Furnizimi i gjykatave/ësve me laptop, është i nevojshëm sepse materialet do të mund t'i sistemojnë, për një përpunim më të lehtë të informacioneve, dokumenteve dhe do t'u

lejonte atyre në mënyrë më konfidenciale të menaxhonin me të dhëna dhe shkresa të caktuara, veçanërisht gjatë punës në terren.

Siç kemi parë në shume raste gjykatesit të cilët gjatë punës së tyre mbajnë séancë jashtë objektit të gjykatës siq janë dalja në vend të ngjarjes apo rikonstruimi i vendit te ngjarjes etj. obligohen që procesverbalet t'i shkruajnë me dorë në mungesë të një Lap-Topi. Elmaze Syka kryetare e gjykates së Pejës, në Gusht të vitit 2014, i ka thënë Emisionit Drejtësia në Kosovë⁸ se mospajisja e gjykates me Lap-Top, ka shkaktuar shumë probleme për këtë gjykatë për shkak se gjatë daljes në terren gjykata i harton procesverbalet me shkrim. Syka ka treguar se disa herë kishte kërkuar në Sekretariatit e KGJK-së që gjykata të paiset me pajisje të tilla mirëpo kjo kërkesë nuk ishte miratuar. Pas publikimit të këtyre shqetësimeve, kemi kuptuar se Sekretariati i KGJK-së ka vendosur që kësaj gjykate t'i ofrojë dy Lap Top për nevojat e gjykatës.

Për BIRN-in , është shqetësues fakti që për kërkesa kaq të domosdoshme e njëkohësisht minimale, si është një lap-top me çmim jo të lartë, është e nevojshme që kryetarët e Gjykatave të dalin në media e të shprehin ankesa të tyre, e vetëm pas kësaj KGJK-ja të ndër marrë veprime të nevojshme për plotësimin e kërkesave elementare të gjykatës.

Monitoruesit e BIRN-it, gjatë monitorimit të rregullt të tyre, i kanë kushtuar rëndësi kësaj pjese të posedimit të këtyre pajisjeve dhe përdorimit ose mospërdorimit të tyre nga ana e gjykatave, dhe konstatimet janë si vijon:

- Gjykata Themelore e Prishtinës, prej gjithsej 4 sallave, vetëm njëra nga ato e ka të pajisur me mjete për audio-incizim të seancave, por e njëjta pajisje përdoret shumë rrallë. Sa i përket pajisjes me lap-top, të pajisur në këtë gjykatë janë vetëm disa nga gjyqtarët.
- Gjykata Themelore në Prizren, i ka të pajisura të gjitha sallat dhe zyret e gjyqtarëve me

kompjuter, kurse me lap-top nuk është pajisur ndonjëri nga gjyqtarët. Ka një sallë të pajisur për audio dhe video-incizim, e cila pajisje përdoret gjatë seancave edhe nga vendorët por edhe në seancat e mbajtura nga EULEX-i. Kjo Gjykatë ka edhe arkivim adekuat të seancave të mbajtura në përfaqësisht 10 vitet e fundit. Kurse degët e kësaj gjykate në Suharekë dhe Dragash, nuk janë të pajisura me pajisje për incizim dhe gjykatësit nuk janë të pajisur me lap-top.

- Gjykata Themelore e Pejës aparaturën e audio-incizimit e ka jashtë përdorimit, për shkak të prishjes, e për pasojë është amortizuar e gjithashtu edhe monitori për shpalljen e seancave gjyqësore është jashtë përdorimit. Përsa i përket pajisjes së gjyqtarëve me kompjuterë, janë të pajisur edhe gjyqtarët në Gjykatën Themelore – selia në Pejë edhe gjyqtarët nëpër degët e kësaj gjykate.
- Gjykata Themelore në Gjakovë, nuk është e pajisur me mjete për audio-incizim, kurse me kompjuter dhe pajisje teknike të tjera (printerë) është e pajisur mirë. Mungesë e ka furnizimin me laptop të kësaj gjykate, për procedurat jashtë objektit të gjykatës.
- Gjykata Themelore Gjakovë, dega në Rahovec dhe dega në Malishevë, nuk kanë fare pajisje për incizim dhe gjykatësit nuk janë të pajisur me laptop.
- Gjykata Themelore në Gjiilan, i ka të pajisura të gjitha sallat me kompjuter, kurse me pajisjen e audio-incizimit e ka të pajisur vetëm një të njërin sallë dhe kjo pajisje përdoret shumë rrallë, kryesisht në seancat e EULEX-it.
- Gjykata Themelore e Mitrovicës, nuk është e pajisur me lap-top fare kurse në seancat e mbajtura nga EULEX-i në pjesën veriore të Mitrovicës, gjykatësit janë të pajisur me monitora për kontrollim të asaj çka shënohet në procesverbal dhe gjithashtu me pajisje për lidhje me dëshmitarët e mbrojtur.

8 <http://www.drejtisianekosove.com/sq/Emisione/Gjykata-e-Pejes-1223>

- Gjykata Themelore në Ferizaj, asnjëra nga sallat nuk është e pajisur me sistem të audio-incizimit. Me kompjuterë janë të pajisura të gjitha sallat e gjykimeve. Ndërsa me laptop gjatë vitit 2014 janë pajisur këta persona: Kryetari i Gjykatës, Administratori Regjional i Gjykatës, Anëtari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Gjykata Thelemore në Ferizaj, Gjyqtari mbikqyrës i Degës së Kaçanikut, Ndhmës Administratori i Degës së Kaçanikut, Gjyqtari mbikqyrës i Degës së Shtërpcës dhe Ndhmës Administratorja e Degës në Shtërpce.

Përkundër vështirësive që hasen me pajisjet teknike nëpër gjykata, disa nga gjykatat (Prizreni, Mitrovica – dega Vushtrri, dhe Peja) kanë treguar gatishmëri për nisjen e praktikës së transmetimit direkt të seancave gjyqësore.

B. PALLATI I DREJTËSISË SI SHPRESË PËR PËRMIRËSIM

Pallati i Drejtësisë, ndërtimi i të cilit filloi më 3 Qershor të vitit 2011, ndërsa parashihej të përfundohej brenda një periudhe 24 mujore, gjegjësisht përgjatë vitit 2013, u bë funksional në vitin 2015. Projekti më herët parashihej të ndërtohej bazuar në ligjin e vjetër për gjyqësor. Atëkohë rregullimi i brendshëm i gjykatave dallonte nga ai aktual, që hyri në fuqi në vitin 2013.

EUO ka vazhduar me ridizajnimin dhe ekzekutimin e punëve shtesë (0,45 mil EUR), të nevojshme për sigurimin e hapësirës shtesë të punës për të akomoduar ndryshimet në përputhje me Ligjin e Ri të Gjykatave (ka hyrë në fuqi në janar 2011,) në ndërtesat A dhe B, financuar nga EUO. Megjithatë, edhe pse institucionet e Prokurorisë janë prekur nga Ligji i ri mbi Gjykatat, ndërtesa C (e financuar nga QK) është e ndërtuar sipas kërkesave të punëdhënësit fillestar, duke mos marrë parasysh nevojat nga Ligji i ri mbi Gjykatat.

Sipas legjislacionit të vjetër gjyqësor, në Pallatin e Drejtësisë parashihej të vendoseshin: Gjykata Kushtetuese, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Gjykata Supreme, Gjykata Ekonomike, Gjykata e Lartë për Kundërvajtje, Gjykata e Qarkut e Prishtinës, Gjykata Komunale e Prishtinës, Gjykata për Kundërvajtje e Prishtinës, Prokuroria Speciale, Prokuroria e Shtetit, Prokuroria e Qarkut e Prishtinës, Prokuroria Komunale e Prishtinës dhe Institucionet ndërlidhëse⁹. Të gjitha duhej të funksionin në pesë objekte të ndara, brenda pallatit të drejtësisë.

Ndërsa ndryshimet në gjyqësor, prej janarit të vitit 2013 krijuan Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Themelore, në të cilën futën gjykatën për kundërvajtje, gjykatën komunale dhe atë të qarkut, të organizuara në shumë departamente.

I ndërtuar në një tokë prej 2.5 hektarësh, i përbërë nga 5 ndërtesa me sipërfaqe prej 50,000 m², kompleksi i Pallatit të Drejtësisë në strukturën e vet, tani do t' i vë nën një kulm të gjitha institucionet gjyqësore dhe prokuroriale të shpërndara nëpër Prishtinë: Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Gjykatën Supreme të Kosovës, Gjykatën Themelore të Prishtinës, Gjykatën e Apelit, Prokurorinë e Shtetit dhe atë Speciale, Prokurorinë e Apelit dhe atë Themelore të Prishtinës. Duhet përmendur megjithatë që përkundër faktit që Gjykata Kushtetuese është dashur të kalojë në këtë Pallat, në vend të saj in do të kalojë Prokuroria Speciale. Sa i përket Gjykatës Kushtetuese - është konfirmuar nga GJK se ata do të lëvizin në Pallatin e Drejtësisë deri në fund të qershorit 2015.

9 <http://www.kjgk-ks.org/?cid=1,174>

Ministria e Administratës Publike, e cila menaxhon me të gjitha ndërtesat shtetërore, na ka njoftuar se ndërtimi i kompleksit në fjalë është produkt i një projekti të përbashkët të BE-së dhe Qeverisë së Kosovës, i cili është i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe MAP-ja. Vlera totale e objektit është 27 milion e 453 mijë e 504.52 euro. Në këtë shumë vlera e financimit për ndërtim nga BE-ja është 22,582,846.00 euro, kurse Qeveria e Republikës së Kosovës ka dhënë 4,870, 658.52 euro. Përveç kësaj BE-ja ka financuar studimin e fizibilitetit dhe projektimin e PD në vlerë 0,8 mil EUR; plus mbikëqyrja e PD 2,6 Mil EUR.

Janë identifikuar disa defekte, të cilat sidoqoftë nuk janë çështje kritike që përfituesi ka ende nevojë t'i kuptojë plotësisht se si tërësia e sistemit është menduar të funksionojë (sikurse HVAC, BMS dhe DMS). Për këto çështje është akoma një mospërcaktim nga ana e stafit kyç se kush do të jetë përgjegjës për një sistem të tillë, veçanërisht me çështjet të lidhura me sigurimin e ndërtesës në kuptimin e aksesit në hyrje, sigurinë e CCTV dhe sistemit të zjarrfikjes. Ka me të vërtetë çështje të vogla me dy ashensorë dhe pjesë këmbimi janë në pritje Kontraktori aktual është duke siguruar transferimin e përditshëm të njohurive, personelit përfitues. Të gjitha çështjet e tjera të vogla me ashensorë janë të lidhura me rregullime të dyerve. EUO Engineer, është në procesin e përditësimit të listës me defektet pengesë në baza të përhershme .

Edhe përkundër faktit se Ministria e Administratës Publike, thotë se është bërë pranimiti teknik i objektit, Pallati i Drejtësisë po del të ketë shumë mangësi dhe vërejtje nga stafi që do të punojnë në të. Andaj këtu lind dyshimi nëse realisht do të mundet ky Pallat të zgjidh problemet teknike të cilat gjykatat i kanë pasur deri më tani.

1. Lokacioni i Ndërtimit të Objektit

Një nga shqetësimet në lidhje me objektin e Pallatit të Drejtësisë, rrjedh të jetë lokacioni në të cilin është ndërtuar objekti, i cili ndodhet 4

kilometra larg qendrës së qytetit. Për Sindikatën e Punëtorëve të Judikaturës problemi më i madh është udhëtimi i organizuar i punëtorve për vajtje-ardhje në punë. Lidhur me udhëtimin e organizuar të punëtorëve, sindikata ka bërë kërkesa të vazhdueshme në Ministrinë e Administratës Publike, në atë të Drejtësisë, në Këshillin Gjyqësor e Prokurorial, nga të cilat kanë pasur premtime që do të bëhet organizimi i transportit kolektiv nga qendra deri në Pallat dhe anasjelltas.

Mirëpo tani që kanë kaluar në objektin e ri, Këshilli Gjyqësor i Kosovës u është përgjigjur punëtorëve se nuk ka mundësi të organizimit e transportit. Poashtu edhe Ministria e Administratës Publike, ka njoftuar Sindikatën e Punëtorëve të Judikaturës se nuk janë të obliguar t'u sigurojnë transportin punëtorëve, por sipas kësaj Ministrie, këtë janë të obliguar ta bëjnë Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial i Kosovës.

“Këshilli Gjyqësor nuk ka mundësi e as kapacitete buxhetore të bëjë transportin, ne do ta kishim bërë këtë por nuk kemi as bazë ligjore që na lejon të mbulojmë transportin. Po mendohet të lëshohen linja urbane me cmime të volitshme për qytetarët” ishte përgjigja e KGJK-së.¹⁰

Ky problem u adresua edhe në takimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës të mbajtur në shkurt, ku prezent' ishte edhe Hajredin Kuçi. Ministri Kuçi kishte premtuar se Ministria e Drejtësisë do ta zgjidh' problemin e transportit të këtyre punëtorëve. Shkëlzen Maliqi – Drejtor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial në të njëjtin takim kishte ngritur shqetësimin se si do të rregullohet një problem i tillë kur nuk ka mjete financiare. Dy javë më vonë, i kontaktuar nga monitoruesit e BIRN – ai tregon se problemet për zgjidhjen e kësaj çështje janë të mëdha akoma.

Mirëpo Sindikata e Punëtorëve të Judikaturës, kanë paralajmëruar se janë të vendosur në këtë drejtim.

“Nëse nuk sigurohet transporti do të jetë problem dhe do të kemi telashe, punëtorët këto ditë kanë kërkuar që të veprojmë por për shkaqe objektive kemi vendosur që të presim përgjigje nga ministri i drejtësisë”.¹¹

Pallati i Drejtësisë i ndërtuar 4 kilometra larg qendrës së Prishtinës, ka mungesë në afërsi edhe të lokaleve për ushqim, gjë e cila është pengesë për punëtorët që punojnë në atë objekt.

“Njerëzit e marrin bukën nga shtëpia sepse nuk kanë me çfarë të ushqehen këtu”.¹²

Në realitet asnjë punëtor thuhet se nuk është i kënaqur me zhvendosjen në këtë objekt, për shkak të largësisë dhe mos mundësisë të organizimit të transportit publik, mirëpo punëtorët kanë qenë të detyruar të barten, ngase kanë marrë urdhëresë nga qeveria për t'u bartur në objektin e Pallatit të drejtësisë.

“Donatori që i ka dhënë të hollat, ka pas nevojë të shohë edhe rezultatin e arritur dhe ajo ka qenë arsyeja që thotë se “nëse nuk dalin, ne kemi për t’ua ndalur të gjitha ndihmat e IPA-s”, dhe kjo ka qenë arsyeja që të gjitha institucionet tona u dashtë të mobilizohen dhe të fillohet puna”.¹³

2. “Drejtësia Afër Qytetarit”

Në çdo vend të botës ekziston parimi se “drejtësia duhet t’ i ofrohet qytetarit” në Prishtinë me ndërtimin e Pallatit të Drejtësisë ka ndodhur e kundërta.

“Kemi pas shumë vështirësi me ardhë deri te Gjykata, e me dije koft se kjo po na krijon shpenzime, shumë më mirë do të ishte që Gjykata të ishte më afër qytetit” tha njëri nga qytetarët që kishte shkuar për të dëshmuar në një rast në gjykatë¹⁴

I pari i KGJK-së thotë se kjo çështje është vendosur në vitin 2008/09.

“Unë nuk kam qenë në proces dhe nuk e di si është vendosur, përshtypja ime lidhur me këtë çështje është se në çdo vend të botës, Gjykatat janë në qendër të qytetit, ajo është një fakt notor, mirëpo arsyeshmëria ka thënë që “Prishtina e Re” me të gjitha institucionet edhe ato qeveritare do të kalojnë në atë pjesë, se kur do të kalojnë nuk e di, por kjo ka qenë një prej përgjigjeve që janë dhënë”.

Mungesa e transportit krijon probleme të mëdha. Kostoja për qytetarët do të jetë e lartë, shumë nga dëshmitarët nuk do të mund ta përballojnë këtë, marrë parasysh gjendjen ekonomike në vend. Edhe nëse ekziston një mjet transporti do të jetë problem për palët kundërshtarë ngase udhëtimi me kilometra në një mjet udhëtimi, mund të krijojë konflikte të cilat pothuajse janë të pashmangshme.

11 Asllan Rusinovci, kryetar i Sindikatës së Punëtorëve të Judikaturës

12 Asllan Rusinovci, kryetar i Sindikatës së Punëtorëve të Judikaturës

13 Enver Peci, kryesues i KGJK-së.

14 Elez Elezi, qytetar nga fshati Smirë

“Konsideroj se ky Pallat është dashur të ndërtohet dikund tjetër, ashtu siç është në botën e qytetëruar, ku njerëzit që kanë halle t’i qasen Gjykatës me lehtësi, sepse këtu realizohen të drejtat e qytetarëve”.¹⁵

Punëtorët të shqetësuar për mungesë transporti, kanë paralajmëruar se nëse nuk do t’u bëhet zgjidhja sa më parë, do të ndërpresin punën. Shqetësimi i tyre edhe më shumë është rritur nga fakti se gjykatësve dhe prokurorëve u është bërë zgjidhje, ndërsa ata kanë mbetur në mëshirë të fatit.

“Të gjithë Prokurorëve dhe Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Apelit, u është siguruar transporti dhe atë me mjete zyrtare, ndërsa për punëtorët nuk është vendosur asgjë, kjo është katastrofale”.¹⁶

Objekti i ndërtuar larg qendrës së qytetit paraqet pengesë edhe për avokatët. Zyret e tyre janë të koncentruara kryesisht në qendër dhe po të njëjtit përpos mungesës së infrastrukturës që mungon në pallat, problem tjetër do të kenë afërsinë e tyre për t’u dhënë ndihmë klientëve, e drejtë kjo e garantuar me ligj.

3. Akomodimi i Stafit në Pallat

Nga janari i këtij viti Pallati i Drejtësisë hapi dyert për gjykatësit prokurorët dhe stafin mbështetës. Nga 2 shkurti, Gjykata e Apelit të gjitha shërbimet dhe seancat gjyqësore i kryen në objektin “B” në Pallatin e Drejtësisë. Pos Gjykatës së Apelit, në Pallat është vendosur

edhe Gjykata Supreme si dhe Prokuroritë, por vështirësitë më të mëdha për zhvendosje i ka Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore të Prishtinës, e cila ende vazhdon punën në objektin e vjetër në qendër të qytetit.

Mos-bartja e Gjykatës Themelore, po shkakton probleme edhe në punën e Prokurorisë.

“Ne si prokurori me të gjitha departamentet jemi bartur me një urdhër të Ministrisë së Drejtësisë, mirëpo është shqetësuese se departamenti i përgjithshëm i Gjykatës Themelore nuk është transferuar dhe po na paraqet probleme, pasi që prokurorët e këtij departamenti po duhet të udhëtojnë dhe po humbin kohë në udhëtim”.¹⁷

Pos vështirësive me bartjen e Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore të Prishtinës, shqetësues është edhe akomodimi i stafit të EULEX-it të cilët do të zënë vend në Pallatin e Drejtësisë, për shkak të numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve që ata kanë. E vetmja zgjidhje në Pallat, duket të jetë përfundimi i mandatit të EULEX-it.

“Unë po shpresoj që me përfundimin e mandatit të EULEX-it, ka me u zgjidhë përgjithmonë problemi sa i përket Pallati të Drejtësisë dhe numrit të stafit, po edhe Gjyqtarëve të të gjitha niveleve që janë në Komunën e Prishtinës”.¹⁸

15 Ramiz Krasniqi, avokat

16 Sadri Llumnica, përfaqësues i Prokurorisë së Apelit dhe asaj Themelore në Prishtinë

17 Ymer Beka, kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë

18 Enver Peci, kryesues i KGJK-së

4.28 Salla të Gjykitimit

Objekti “D” është ndërtuar enkas për salla gjyqësore, respektivisht do të përfshijë 28 salla të gjykitimit. Vendi i mbajtjes së seancave gjyqësore në vazhdimësi ka qenë njëra nga të gjeturat e monitorimit të BIRN-it. Sipas të dhënave që dalin nga monitorimi i BIRN, del se edhe në vitin 2014 ka pasur raste kur gjykitimet janë mbajtur në zyre të gjykatësve e jo në salla të gjykitimit, njëra ndër arsyet ishte edhe mungesa e sallave të gjykitimit.

Gjykata Themelore e Prishtinës, ka qenë njëra ndër gjykatat me mungesë të sallave për gjykim, gjë që ka ndikuar edhe në mungesën e transparencës për të intersuarit për pjesmarrje në gjykim. Mos-përfillja e obligimit për incizim të seancave gjyqësore, e cila përcaktohet edhe me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës¹⁹ është një e gjetur tjetër që është shumë shqetësuese për gjykatën e Prishtinës. Edhe tani, në ndërtesën “D”, në Pallatin e Drejtësisë mungojnë paisjet për audio dhe video- incizim të seancës gjyqësore.

Duke marrë parasysh se vetëm Gjykata Themelore e Prishtinës ka 52 gjykatës madje në pritje për emërim janë edhe 20 gjykatës tjerë në këtë Gjykatë, të cilët janë të gatshëm për emërim, por problemi është te mungesa e kuorumit të KGJK-së, të cilët presin funksionalizimin nga Kuvendi i Kosovës. Me plotësimin e numrit të gjykatësve në Gjykatën Themelore, pastaj marrë parasysh edhe ata të gjykatës së Apelit, me 28 salla të gjykitimit vështirë se do të realizohet aplikimi i nenit 208 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

BIRN, edhe këtë vit do të vazhdojë të përcjellë punën e gjykatave dhe do të shoh se sa do të respektohet mbajtja e gjykimeve në salla të gjykitimit dhe sa prej tyre do të përcjellen me audio dhe video- incizim.

5. Probleme tjera në pallat

Monitoruesit e BIRN kanë hulumtuar, takuar dhe intervistuar shumë palë të cilët janë të involvuara rreth punëve në Pallatin e Drejtësisë. Pjestarë të policisë së Kosovës, të cilët janë caktuar për ruajtjen e rendit dhe sigurisë në objektet e Gjykatave dhe Prokurorive në Pallatin e Drejtësisë, transferimin në Pallat nuk e shohin të kompletuar.

Sipas palëve me të cilat monitoruesit tanë kanë biseduar (policë, avokatë, prokurorë dhe gjyqtarë) një ndër shqetësimet më të mëdha të tyre është mungesa e hapësirave të posaçme për vendosjen e të akuzuarve të cilët sillen në gjykatë për t’u gjykuar. Probleme tjera teknike janë, mungesa e dritareve, problemet me ashensorë, rrjedha të ujit nga plafoni, mos-funksionimi i ngrohjes etj.

Ndërsa, si pozitive në Pallatin e Drejtësisë, konsiderohet të jetë niveli i lartë i sigurisë dhe risia në këtë objekt është shërbimi postar dhe ai bankar të cilat do të jenë në kuadër të kompleksit.

Sipas Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë Imer Beka, si problem më i madh dhe shqetësues është fakti se në objekt nuk ekzistojnë dhomat për mbrojtje, si dhe dritaret në objekt nuk mund të hapen. Shqetësim tjetër për kryeprokurorin është edhe ventilimi në objekt. Sipas kryeprokurorit Beka, në këtë objekt në të cilin është vendosur Prokuroria të cilën ai e udhëheq duhet ende të intervenohet, sepse nuk ka kushte të mjaftueshme për punë.

19 Neni 208 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

C. SHKELJET PROCEDURALE

Krahas vështirësive dhe problemeve në implementimin e ndryshimeve, në gjyqësorin e Kosovës kanë vazhduar të identifikohen shkeljet procedurale të dispozitave procedurale penale gjatë shqyrtimeve gjyqësore, përkundër faktit se tashmë janë bërë dy vite prejse Kodi i Ri Penal dhe ai i Procedurës Penale kanë hyrë në fuqi.

Derisa Kodi i Procedurës Penale i Kosovës parasheh shprehimisht rastet kur gjykatat duhet të respektojnë veprimet e ndryshme procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor²¹, monitoruesit e BIRN kanë identifikuar se jo në të gjitha rastet respektohen veprimet procedurale, të cilat edhe parashihen në dispozitat procedurale penale.

Ndër evidentimet e shumta të shkeljeve procedurale këtë vit, BIRN ka identifikuar shkeljet si:

- Problemet me përkthimin e duhur
- Mos-leximi i te drejtave të dëshmitarit dhe mos menaxhimi korrekt i lëndëve
- Mos respektimi i afateve gjyqësore të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale
- Mos përfshirja e deklarimeve në procesverbal
- Mos respektimi i afateve ligjore për shpalljet e aktgjyqimeve
- Mos leximi i aktakuzës në shqyrtimin fillestar
- ...e të tjera.

Shkeljet procedurale të lart-përmendura ishin ato më të shpeshta që monitoruesit e BIRN-it kanë vërejtur. Kjo nuk ishte një zgjedhje se cila shkeljet procedurale duhet të monitorohen, por vëzhguesit tanë gjatë seancave të monitorimit kanë identifikuar cilado parregullsi dhe ato të

listuara në këtë raport vjetor, janë përsëritur nga seanca në seancë, duke qenë më të shpeshtat.

Sa i përket shkeljeve procedurale të evidentuara gjatë monitorimit të BIRN, fillimisht do të nisim shpjegimin e gjetjeve tona në formë të përgjithshme, duke adresuar kështu substancën e problemeve në mënyrë që të krijojmë një ide të përgjithshme në lidhje me shkeljet procedurale, për të vazhduar me raste specifike gjatë përmendjes së të cilave do të adresohen shkelje të tjera procedurale.

Përgjatë monitorimit të seancave të bërë nga monitoruesit e BIRN, janë vërejtur probleme të ndryshme procedurale të cilat shumë herë janë konsideruar si shkelje.

Problem shqetësues kur vije të shkeljet procedurale është edhe çështja e përkthimit. Mos-përkthimi i saktë në gjuhën të cilën e kupton i pandehuri, ose mos-përkthimi fare i fjalëve të caktuara – konsiderojmë se është në kundërshtim me të drejtat elementare të të pandehurit, sic është në këtë rast përkthimi në gjuhën të cilën e flet vetë i pandehuri, më saktësisht, kjo bie ndesh me nenin 14 par.2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Shtyerja e seancave në distancë të largët kohore nga njëra-tjetra si dhe marrja në pyetje e dëshmitarëve në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës janë shkelje të tjera që janë vërejtur gjatë monitorimit të bërë nga monitoruesit e BIRN.

Mos-leximi i te drejtave të dëshmitarit dhe mos menaxhimi korrekt i lëndëve që si rezultat shkojnë në dëm të të akuzuarit. Rasti që kemi zgjedhur si ilustrim të këtij problemi njihet si rasti i Besnikëve në Gjykatën Themelore të Gjakovës (B.H. dhe B.R.) të cilët që në moshën e mitur kanë kryer vepra penale të vjedhjes në bashkryerje lidhur me nenin 23. B.R. ka mbi 90

²⁰ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20i%20procedures%20penale.pdf>.

Aktakuza të ngritura nga Prokuroria Themelore në Gjakovë nga Departamenti i Përgjithshëm i kësaj Prokurorie, kryesisht për veprën penale të vjedhjes së rëndë. Kryesisht në të njëjtat raste është i përfshirë edhe B.H. duke përjashtuar raste të cilat janë përfshirë edhe të akuzuar të tjerë. Të njëjtit janë në vuajtje të denimit për vepra të mëhershme të cilat kanë marrë Aktgjykim të plotfuqishëm. Në procedurën e fundit të monitoruar nga monitoruesit e BIRN ndaj të akuzuarve B.H. B.R. Sh.M. dhe A.S., të datës 17.12.2014 të bashkuara 4 lëndë në një procedurë me numër lënde 43/12, 596/12, 109/12, 341/11 për veprat penale të vjedhjes së rëndë, B.H. në sallën e gjykatës deklaroi që deri më tani i janë akumuluar 12 vjet e 6 muaj burg efektiv. Ndërsa B.R. tha se ende nuk i ka përfunduar lëndët e vitit 2012.

Duke bërë një parallogari, dëmet e shkaktuara të të akuzuarve nuk e kalojnë vlerën e mbi 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë euro) sepse në cdo aktakuzë thuhet: *P.Sh. ka thyer xhamin e kioskes dhe ka vjedhur 5 pako cigare, para të gatshme në vlerë 50 euro etj të ngjajshme*. Sanksioni më i ulët për këto vepra penale që gjykata mund të shqiptojë është 6 muaj burg.

Për 90 vepra penale nga 6 muaj burgim sipas kalkulimeve dalin 540 muaj burg, respektivisht 45 vjet. Gjykata ka mundur që rastin e “Besnikëve” ta gjykojë në një procedurë të vetme duke i bashkuar të gjitha procedurat dhe duke ju shqiptuar një dënim unik dhe që do rezultonte edhe me ekonomizimin e procedurës, duke qenë se të gjitha këto i mundëson ligji. Ndërkaq duke e përcjellur praktikën që Gjykata ka nisur - për dëme në vlerë jo më të madhe se 15 mijë euro dënimi po rezulton të jetë më i madh se për veper penale të vrasjes.

Shqetësues është edhe fakti i shkeljeve esenciale të procedurës penale. Rast të tillë monitoruesit e BIRN kanë hasur në lëndën me numër P.nr.45/14 kur Kryetari i trupit

gjykues edhe më parë kishte marrë veprime në të njëjtën lëndë si gjykatës i procedurës paraprake, gjë që bie ndeshë drejtpërdrejtë me Kodin e Procedurës penale të Kosovës dhe atë me nenin 384 paragraf 1 nënpar.1.1, krejt kjo lidhur me nenin 39 të KPPK-së.

Gjithashtu mosrespektimi i afateve gjyqësore të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale është problem që duhet të ceket. Në njërin nga rastet e monitoruara nga BIRN me numër të lëndës P.nr.19/2014 shpallja e aktgjykimit u shty për datën 26.11.14, ndërsa shqyrtimi gjyqësor u konsiderua i mbyllur më datë 20.11.14. Kjo, vlerësojmë që është në kundërshtim me nenin 366 dhe atë më paragrafin 1, sipas të cilit thuhet se koha e shpalljes së aktgjykimit duhet të bëhet më së shumti tri ditë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Ndërkaq problemi i përkthimit që u përmend më lartë duket se shtrihet më larg se aq, meqenëse kemi edhe rastin e mos konstatimit të fjalëve të thëna nga i akuzuari në procesverbal. Derisa i akuzuari F.M., jepte deklaratën e tij para trupit gjykues dhe merrej në pyetje nga mbrojtja, fjalët e tij për rreth 20 minuta nuk kanë hyrë fare në procesverbal.

D. KU? KUSH? PSE? Specifika rastesh.

RASTI SINA – DËSHTIM I SISTEMIT

Skender Sina nga Gjakova²¹, ishte akuzuar më 16 Nëntor 2005 nga Prokuroria Komunale në Gjakovë në atë kohë, që në cilësinë e personit zyrtar kishte marrë rryshfet në shumë prej 20.000 Euro, me çka kishte kryer veprën penale të “ marrjes së rryshfetit “ nga neni 343 par 1 të KPPK-së, mirëpo kjo akuzë ndaj Sinës

Fillimi i gjykimit

Më 26 tetor 2007 lënda me P.nr 77/2007 lidhur me Skënder Sinën, ishte shqyrtuar në Gjykatën Komunale në Deçan, dhe nga kjo gjykatë Skender Sina ishte dënuar me 12 muaj burgim. Kundër verdiktit të kësaj gjykate është parashuar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë, si gjykatë e shkallës së dytë dhe po e njëjta gjykatë lidhur me këtë kishte vendosur që lëndën t'a kthejë në rishqyrtim sa i përket pjesës ndëshkimore. Gjykata e shkallës së dytë, poashtu kërkoi vërtetimin e provave materiale të cilat ishin në shkresat e lëndës. Udhëzimi i shkallës së dytë ishte që një audio incizim i kryer nga i dëmtuari, të dërgohet për analizë në laboratorin e forenzikës për të vërtetuar autenticitetin e tij e poashtu për të verifikuar nëse zëri në atë audio ishte i të pandehurit.

Në pritje të parashkrimit

Kjo lëndë pas këtij vendimi të Gjykatës së Qarkut në Pejë, kishte mbetur në sirtaret e Gjykatës Komunale në Deçan, mirëpo monitoruesit e BIRN-it ishin njoftuar në lidhje me këtë dhe pas hulumtimit dhe transmetimit të këtij rasti, në emisionin "Drejtësia në Kosovë", gjyqtari i cili në vitin 2007 e kishte dënuar Sinën me një vit burgim, vendim të cilin shkalla e dytë i'a kishte anuluar, tani si gjyqtar i Gjykatës Themelore merr vendim që seancën lidhur me këtë rast t'a caktojë prapë pas 7 vitesh, dhe e cakton seancën për 5 shkurt 2014. Siç shihej nga shkresat e lëndës, data 5 Shkurt përkonte me datën kur kjo lëndë do t'i nënshtrohej parashkrimit absolut për shkak se kishin kaluar dhjetë vite nga dita kur prokuroria pretendonte se ishte kryer vepra penale. Edhe pse pritej që në këtë seancë gjyaktësi të merrte vendim për parashkrimin e lëndës, procedura vazhdoi vetëm atëherë kur prokurori publik kërkoi ndryshimin e aktakuzës, me të cilin veprim ai ndërroi momentin kur ishte kryer vepra penale duke i shtuar kështu jetë edhe për disa muaj kësaj çështjeje.

Neglizhenca lidhur me këtë lëndë

Në dosjen e lëndës e cila u prezantua në seancën e 5 Shkurtit, gjykatësi i lëndës

konstatoi se kishte kërkuar nga Laboratori i Forenzikës si Agjenci e Pavarur që të kryente analizën e audio-incizimit, mirëpo nga ky Laborator kishte marrë përgjigjen negative se kjo analizë nuk mund të kryhet në Kosovë. Për këtë arsye, gjykatësi njoftoi se i ishte drejtuar Departamentit për ndihmë Juridike ndërkombëtare në Ministrinë e Drejtësisë mirëpo ata deri në seancën e 5 Shkurtit nuk e kishin njoftuar gjykatën me ndonjë përgjigje, qoftë ajo pozitive apo negative.

Përgjigjia e kërkuar është marrë vetëm atëherë kur emisioni "Drejtësia në Kosovë" kishte publikuar faktet të cilat tregonin neglizhencën e Ministrisë së Drejtësisë në trajtimin e kërkesave të gjykatave. Një ditë pas transmetimit të hulumtimit, Ministria e Drejtësisë dërgoi një letër sqaruese për institucionet e drejtësisë, për t'a sqaruar këtë rast. Në këtë sqarim ndër të tjera thuhej se: "Ministria e Drejtësisë sqaron, Prokurorinë e Shtetit dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës, se me datën 17.12.2012, ka marrë kërkesë për ndihmë juridike ndërkombëtare nga Gjykata Komunale e Deçanit, lidhur me ekzistimin e Laboratorit që kryen ekspertizën e audio-incizimit, të quajtur "Forensic Bilmiler Net-Scientific Reasearch and Sharing Portal" në Turqi dhe të njoftohet për kushtet mbi të cilat kryhet kjo ekspertizë, lidhur me një kontest gjyqësor që po shqyrtohet nga kjo gjykatë.

Pas pranimit të kësaj kërkesë, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë, duke u bazuar në kompetencat ligjore, ka ardhur në përfundim që kjo kërkesë nuk është në fushë-veprimtarinë ligjore të këtij departamenti - (kjo kërkesë është dashur të dërgohet te Laboratori i Forenzikës në Prishtinë, ku të njëjtit pastaj varësisht nga marrëveshjet që kanë me shtetet e tjera, do ta dërgonin për ekspertizë). Megjithatë, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë, duke qenë i gatshëm çdo herë të mbështes institucionet e gjyqësorit, kërkesën e Gjykatës Komunale të Deçanit e ka përcjellur te autoritetet kompetente të Turqisë me 06.02.2013, por ende nuk ka marrë përgjigje nga ta".

Në sqarimin e tyre, Ministria e Drejtësisë ka pranuar faktin se për më shumë se dy muaj nga data 17.12.2012 deri më 06.02.2013-të nuk e kishte adresuar kërkesën e gjykatës. Madje, në sqarimin e tyre Ministria e Drejtësisë pranonte se ende nuk ka marrë përgjigje në kërkesën drejtuar laboratorit Turk. Në mungesë të kësaj përgjigje lidhur me ekspertizën, gjersa koha e parashkrimit të lëndës po afrohej, Gjykata Themelore e Pejës - dega në Deçan, me 17 Mars te vitit 2014 vendosi që Sinën t'a dënojë prapë me një vit burgim²² me rrezikun e madh që çështja të kthehet në rigjykim për të njëjtën arsye si në rastin e parë, për mungesë të ekspertizës së audio-incizimit.

Gjykata e Apelit në Prishtinë pas apelimit të vendimit të Gjykatës Themelore të Pejës (dega në Deçan), e anuloi vendimin dhe rastin e ktheu në rivendosje, pasi që nuk ishte bërë ekspertiza e zërit.

Kthimi i dytë i kësaj lënde në Rigjykim

Pas kthimit të kësaj lënde në rigjykim, seancat gjyqësore filluan mirëpo sërish paraqiten problemet e njëjta, ku prapë Ministria e Drejtësisë tregon neglizhencë dhe nuk merr masa për kryerjen e ekspertizës së kërkuar. Mirëpo, gjyqtari i rastit është detyruar që disa herë t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë, për të kërkuar ndihmë lidhur me ekspertizën për këtë rast, me qëllim që ky rast të mos parashkruhet.

7.500 Euro për Ekspertizën

Me qëllim që të mos bëhet parashkrimi i kësaj lënde, më në fund Ministria e Drejtësisë vendosi që këtë ekspertizë t'a bëjë një kompani nga Turqia dhe me 10 Tetor, u bë ekspertiza e zërit²³. Pas neglizhencës së shfaqur për një kohë të gjatë dhe bërjes së ekspertizës së kërkuar që nga fillimi i shqyrtimit, raporti i ekspertëve ishte se përputhja e zërit është 60%.

Aktgjykimi lirues

Pas 10 vitesh gjykimi, vije vendimi i Gjykatës, ku trupi gjykues me 22 Tetor 2014 sjell aktgjykim lirues për Skender Sinën²⁴. Është arsyetuar se ekspertiza nuk ka qenë në nivelin e duhur, sepse ka konstatuar vetëm 60% përputhshmërinë e zërit e sipas kryetarit të trupit gjykues, kjo është provë e pa mjaftueshme.

Rezultati lidhur me këtë rast, mund të themi se ka ardhur si shkak i neglizhencës së Ministrisë së Drejtësisë dhe Laboratorit të Forenzikës, ku afro 10 vite nuk kanë mundur t'a sigurojnë kryerjen e një ekspertize më se të nevojshme për rastin në fjalë.

Në këtë rast, përveç Ministrisë së Drejtësisë një pjesë të konsiderueshme në neglizhencë ndaj çështjes në fjalë e kanë edhe Gjykatat dhe Prokuroritë që janë marrë me këtë rast, pasi që për afro 6-7 vite, e kanë lënë në sirtare derisa për këtë rast ka raportuar "Drejtësia në Kosovë".

Përfundimisht, çështja Sina do të ketë fatin e një lënde të parashkruar pasi që edhe përkundër faktit që në shkallë të parë Sina u shpall i pafajshëm prokurori i çështjes, ka ushtruar ankesë. Mirëpo, tashmë lënda është parashkruar pasi kanë kaluar më shumë se dhjetë vite nga kryerja e veprës penale.

TË TJERA

Gjykata Themelore Prishtinë Pnr.271/13, Akuzuar: N.U. e të tjerët.

Shtyhet gjykimi në mungesë të akuzues O.J. Sipas gjyqtarit e akuzuara O.J. gjendet në Beograd për trajtim mjekësor. "Kam bisedu me të në telefon, ajo gjendet në Beograd dhe siç duket është duke u trajtuar atje" tha gjyqtari Sedek. Këtu vërejmë mungesën e informimit të duhur. Ky është vetëm një prej rasteve të

22 <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,7822>

23 <http://live.kallxo.com/sq/MTL/7500-Euro-Ekspertize-nga-Stambolli-ne-Rastin-Sina-2566>

24 <http://live.kallxo.com/sq/MTL/Pas-10-Viteve-Gjykim-Lirohet-Skender-Sina-2758>

shumta ku Gjyqtari e kupton që pala nuk është brenda shtetit – vetëm në ditën e gjykimit.

Monitorimi në çështjen penale: “Shpërdorimi i detyrës zyrtare ose autorizimit” nga neni 339 par.1 vepra penale “Falsifikimi i dokumenteve” nga neni 332 par.1, si dhe vepra penale “Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë” nga neni 334 i KPK-së P.nr.460/13

Fillimisht gjykimi i këtij rasti ka filluar me vonesë, kjo për shkak të vonesës së të akuzuarit H.H. Gjatë tërë seancës gjyqësore të akuzuarit; H.H. N.K dhe V.I. që janë përfaqësues institucional, para gjykatësit rrinin “këmbë mbi këmbë” duke mos treguar respekt ndaj institucionit gjyqësor. Më shumë habitës ishte fakti se vetë gjykatësi nuk ua tërhoqi vërejtjen asnjëherë të akuzuarëve për mosrespekt ndaj gjykatës, (gjë që në raste të tilla cdo here duhet të reagoj dhe zakonisht reagojnë gjykatësit apo trupi gjykues).

Monitorimi në çështjen penale: “Vrasje” nga neni 146 i KPK-së dhe vepra penale: Vrasje në tentativë që rezultoi me lëndime të lehta trupore nga neni 146 lidhur me nenin 2, e lidhur me nenin 153 par.1 dhe 2 të KPK-së P. nr.130/14

Problemi kryesor monitoruesit e BIRN konsiderojnë se ka qenë te marrja në pyetje e ekspertit mjeko-ligjor F.B edhe përkundër faktit se rasti është kthyer në rigjykim, prokurori i cili më parë nuk ka qenë prokuror i këtij rasti (rastin e ka pasur prokuroria e eulexit), insistoi me pyetje ndaj ekspertit, mirëpo ky i fundit nuk u përgjigj me arsyetimin se nuk ishte i përgatitur dhe se për tu përgjigjur duhej t'i ipej kohë. Duke marrë parasysh faktin se ekspertit i ka shkuar ftesa me kohë për këtë rast dhe ka prezantuar në gjykatë për tu deklaruar rreth këtij rasti, ai është dashur që të deklarohet rreth rastit, e jo sic bëri në vazhdimësi duke u thirrur në atë se njëherë ka deklaruar për këtë rast dhe se mbetej në tërësi pranë deklarimit të mëparshëm. Kjo qasje është neglizhencë

ndaj gjykatës dhe si e tillë përbën shkelje procedurale.

Monitorimi në çështjen penale: “heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave” nga neni 414 i Kodit Penal të Kosovës, vepër kjo për të cilën parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 vjet burg P.nr. 1545/14

Në këtë seancë, problem kryesor ka qenë dërgimi i të pandehurit në qendrën e ndalimit në Suharekë, gjë që ka ndikuar edhe në shpenzime si dhe në vonesën prej 1 orë e 10 minuta, derisa i pandehuri është sjellur nga qendra e ndalimit nga Suhareka. Ngase seanca ndëgjimore për caktimin e paraburgimit është planifikuar që të mbahet nga ora 10:30, ndërsa filloi në ora 11:40.

Monitorimi në çështjen penale: Shpërdorimi i detyrës zyrtare nga neni 339 i KPK-së P.nr.115/12

Problem kryesor në këtë seancë gjyqësore ka qenë angazhimi i avokatit i cili që dy seanca me radhë kishte autorizim bartës nga kolegu i tij që në këtë rast edhe vetë avokati i dytë ishte i angazhuar sipas detyrës zyrtare, e jo privatisht. Në këtë rast, avokati i dytë është dashur që ta njoftoj Odën e Avokatëve, për mosprezencën e tij dhe vetë Oda të caktonte avokatin tjetër sipas detyrës zyrtare, e jo sic ka vepruar ai duke e angazhuar avokatin tjetër. Madje konsiderojmë se problem kryesor këtu ka qenë, tolerimi i trupit gjykues ndaj kësaj parregullësie.

Monitorimi në çështjen penale: “Rrëmbimi” nga neni 194 par.1 të KPK-së dhe vepra penale “mashtrimi” nga neni 335 par.1 të KPK-së P.nr .45/14

Gjatë kësaj seance gjyqësore problem kryesor ka qenë fakti, se kryetari i trupit gjykues, edhe më parë kishte marrë veprime në këtë lëndë si gjykatës i procedurës paraprake, gjë që bie ndeshë drejtpërdrejtë me Kodin e Procedurës

penale të Kosovës dhe atë me nenin 384 paragraf 1 nënpar.1.1, krejt kjo lidhur me nenin 39 të KPPK-së. Lidhur me këtë edhe prokurori ia tërhoqi vërejtjen kryetarit të trupit gjykues. Gjë që bëri që seanca gjyqësore të ndërpritet dhe u vendosë që lënda t'i cedohet më tej në procedurë, kryetarit të gjykatës për ndërrim dhe vendosje të kryetarit të ri të trupit gjykues në këtë çështje.

Monitorimi në çështjen penale; Vrasje e rëndë në bashkëkryerje, nga neni 147 par1 nënpar.7 lidhur me nenin 23 të KPK-së. Vepra penale e mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së, si dhe vepra penale, Ndihmë në kryerjen e veprës penale të Vrasjes së rëndë nga neni 147 par.1 nënpar.7 lidhur me nenin 25 të KPK-së P.nr. 217/13

Problemi kryesor gjatë kësaj seance, ka qenë fakti se derisa i akuzuari F.M. jepte deklaratën e tij para trupit gjykues dhe merrej në pyetje nga mbrojtja, fjalët e tij, për rreth 20 minuta nuk kanë hyrë fare në procesverbal, edhe përkundër reagimit të avokatëve dhe të prokurorit, kryetarja e trupit gjykues nuk e ka konstatuar asnjë fjalë në procesverbal. Krejt këtë kryetarja e trupit gjykues tha se e ka bërë për shkak se të njëjtat janë thënë edhe në prokurori nga i akuzuari, ndërsa mbrojtja dhe prokurori thanë se kishte ndryshime në deklaratën e të akuzuarit të cilat nuk janë konstatuar fare në procesverbal. Ndërkaq ne konsiderojmë se edhe në rastet kur fjalët e avokatit, prokurorit e gjykatësit përkrijnë me njëra tjetrën – prapeseprapë duhet të futen ndaras në procesverbal sepse janë fjalë të palëve të ndryshme dhe duhet të ruhen si të tilla.

Monitorimi në çështjen penale; Dy të akuzuarit A.B. dhe B.U., për shkak të akuzave për kryerje të veprës penale: Vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 147 par.1 nënpar.7 lidhur me nenin 23 të KPK-së. Ndërsa i akuzuari i tretë që gjendet në liri akuzohet për veprë penale: dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale

nga neni 305 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së P.nr.19/2014

Problemi me këtë rast është fakti se derisa i akuzuari i dytë jepte fjalën përfundimare, e quante të akuzuarin KRIMINEL, dhe për këtë nuk reagonte trupi gjykues, derisa prokurori reagoi dhe shkëmbyen fjalë me të akuzuarin tjetër, i cili e akuzonte edhe prokurorin se nuk ka bërë si duhet hetime. Një gjë e tillë konsiderojmë se nuk është dashur të lejohet nga trupi gjykues, që ishte i përbërë nga tri gjykatëse profesionale. Poashtu, si shkelje që duhet evidentuar në këtë rast, është fakti se shpallja e aktgjykimit u shty për datën 26.11.14, ndërsa shqyrtimi gjyqësor u konsiderua i mbyllur ditën e sotme (datë 20.11.14). Kjo vlerësojmë që është në kundërshtim me nenin 366 dhe atë me paragrafin 1, sipas të cilit thuhet se koha e shpalljes së aktgjykimit duhet të bëhet më së shumti tri ditë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Shqyrtimi gjyqësor i mbajtur me 23 maj 2014, në çështjen civile Pengim Posedimi Cnr137/14, ku dëgjohej paditësi në cilësinë e palës, gjatë gjithë kohës kishte ndërhyrje edhe nga palët e treta në raport me dëshminë e paditësit. Kjo e detyroi disa herë avokatin i cili e përfaqësonte të paditurin duke kërkuar nga gjykatësi të mbante rend dhe qetësi, duke mos lejuar palët e treta, që të ndikojnë në dëshminë e paditësit. Po ashtu, avokati u ankua edhe për mos përfshirje të deklaratave në procesverbal. Ai disa herë gjatë seancës, kërkoi që të shënohen të gjitha në proces, pasi shumë deklarime të tij nuk po shënohen në procesverbal, për çka procesverbali nuk po është i plotë, nga ajo që po thuhet në seancë.

Po ashtu edhe Seanca e mbajtur me 30.10.2014, me palë të njëjta, por me numër të ndryshëm, pasi rasti është kthyer në rishqyrtim, tani me numër Cnr-398/14 kishte probleme procedurale gjatë zhvillimit të seancës. Problemi kryesor, gjatë kësaj seance, ishte mos menagjimi i duhur i seancës nga ana

e gjykatësit dhe mos përfshirja e deklarimeve në procesverbal. Gjatë seancës, paditësi dhe një palë nga publiku, që ishte me paditësin ishin shumë të zhurmshëm në seancë, ndërsa gjykatësi ishte shumë tolerant ndaj tyre, në disa raste as që ua tërhoqi vërejtjen, pasi të njëjtit, nuk guxojnë të flasin në seancë, as paditësi, kur ka avokat, pa lejen e gjykatësit, e aq më pak një palë nga publiku. Paditësi, e kërcënoi, së bashku me palën nga publiku, avokatin, ndërsa me insistimin e avokatit u shënuar në procesverbal, pasi gjykatësi as që dëshiroi të shënojë në proces këtë veprim, ndërsa, vetëm me insistimin e avokatit, paditësi së bashku me palën, gjykatësi i largoi nga salla e gjykimeve, për shkak të kërcënimit të avokatit. Po ashtu avokati, disa herë u ankua për mos shënimin në proces të deklarimeve të tij.

Në rastin e shpërdorimit të detyrës zyrtare në lidhje me R.M. me numër lënde P/nr. 171/ 13 ishte planifikuar që të dëgjohet mbrojtja e të akuzuarit M.K. dhe dëgjimi i fjalës përfundimtare të vetë të akuzuarve. Mirëpo për shkak se njëra nga anëtarët e trupit gjykues, ishte e angazhuar në një rast tjetër i cili sic u tha duhej të mbahej në Prishtinë, trupi gjykues mori vendim që seanca e së martës të ndërpritet. Kjo ishte neglizhencë e vetë trupit gjykues, duke marrë parasysh veprën dhe rëndësinë e rastit, për aq më tepër kur në pyetje është personi publik dhe cdo vonesë në gjykatë, do të krijojë edhe vonesa të mëtutjeshme në procedura apeluese të rastit. Data 27, ishte data në të cilën pritej të merret aktgjykimi përfundimtar për këtë rast, mirëpo në pamundësi që të kryhet fjala përfundimtare nga vetë të akuzuarit, madje edhe prokurorja e rastit do të japë një fjalë përmbyllëse, trupi gjykues mori vendim, që në këtë datë të vazhdohet me fjalën përfundimtare të mbrojtjes, ndërsa caktoi edhe dy data në muajin mars. 14 marsi, mbeti dita në të cilën do të vendoset për fatin M.K. dhe pesë zyrtarëve tjerë komunal të Prizrenit.

Lënda "Mashtrimi" me numër të lëndës P.nr. 444/13 sjell si problem kryesor gjatë kësaj séance gjyqësore, mospërkthimin e saktë

palës së pandehur, ngase shpeshherë, fjalët që fliteshin nuk i përktheheshin të pandehurit (nga interpreti gjyqësor). Konsiderojmë se kjo është në kundërshtim me të drejtat elementare të të pandehurit, sic është në këtë rast përkthimi në gjuhën të cilën e flet vetë i pandehuri, më saktësisht, kjo bie ndeshë me nenin 14 par.2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, në të cilin thuhet:

"Personi i cili merr pjesë në procedurë penale i cili nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, ka të drejtë të flasë gjuhën e vet dhe të jetë i informuar nëpërmjet përkthimit pa pagesë me faktet, provat dhe procedurën."

Madje i pandehuri, J.M.M.R. gjatë kohës së merrej në pyetje nga avokati i tij, në momentin kur u ftua që të identifikojë nënshkrimin e tij në deklaratën e dhënë në polici, u deklarua "është e vërtetë që është nënshkrimi im, mirëpo para se të nënshkruaja deklaratën, nuk e kam ditë cka përmbanë, ngase nuk më është lexuar e përkthyer edhe njëherë para nënshkrimit". Kjo bie ndeshë drejtpërdrejt me neni 207 paragrafi 1 i KPPK-së. Kjo seancë poashtu filloi me vonesë, ngase të pandehurit, të sjellur nga paraburgimi së bashku me avokatët mbrojtës pritën 25 minuta derisa gjykata siguroi përkthyesin nga gjuha Angleze në gjuhën Shqipe dhe anasjelltas. Për më tepër, edhe përkundër faktit se për këtë ditë ishte planifikuar që të merren deklaratat e të pandehurve, asnjëri nga ta nuk mundi ta kryejë dëshminë, për shkak se pas orës 13:00 përkthyesi nuk mundi të qëndroj në gjykatë, ngase ishte i obliguar që të ligjëroj në shkollë, ku edhe ishte i angazhuar me pagë mujore. Kjo bie ndesh drejtpërdrejt me parimin për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe në afat të arsyeshëm, e drejtë kjo që parashihet jo vetëm me KPPK por edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nga e gjithë kjo konsiderojmë se është shkelur Kodi i Procedurës Penale të Kosovës dhe atë saktësisht neni 5 paragrafët 2 dhe 3 të këtij kodi.

Ndërkaq, monitorimi i seancave të EULEX i bërë nga monitoruesit tanë, ka evidentuar shkelje procedurale konsiderueshëm më të pakta. Megjithatë ato ishin ekzistente dhe disa prej tyre i përmendim më poshtë:

Në "Rastin e Pasaportave" më numër të lëndës Pkr. 1046/13 ku të akuzuar janë N.V. dhe 8 të tjerë, tashmë të dënuar, pas dhënies së fjalës përfundimtare të Prokurorit, dhe avokatëve mbrojtës, prokurori i rastit, përsëri ka bërë një lloj përgjigje në fjalën përfundimtare të avokatëve mbrojtës, duke tërhequr kështu edhe përgjigjen e avokatëve. Kjo seancë është mbajtur me 2 dhjetor.

Nga të gjitha seancat e monitoruara me gjyqtarë të EULEX gjatë këtij viti, ky ka qenë rasti i vetëm që pas përfundimit të fjalës përfundimtare të avokatëve mbrojtës të të akuzuarve, Prokurori ka vazhduar përsëri me paraqitjen e fjalës së tij përfundimtare, ku ka komentuar dhe është përgjigjur në pretendimet e avokatëve mbrojtës të të akuzuarve.

Gjithashtu, një tjetër një dukuri që është paraqitur pothuajse në të gjitha seancat e udhëhequra nga gjyqtarët e EULEX-it, është edhe ajo e një tolerimi shumë të madh që ju bëhet të pandehurve. Të pandehurit kërkojnë fjalën, zakonisht për t'ju bërë pyetje dëshmitarve, por ata nuk bëjnë pyetje por e shfytëzojnë këtë kohë për komentime të shumta, duke i marrë kohë të cmuar Gjykatës.

Gjithashtu një shkelje tjetër që është bërë, është edhe ajo e mos-leximit të aktakuzës, kjo ka ndodhur në një rast në Ferizaj me numër të lëndës Pkr. 116/14, ku të akuzuarit akuzoheshin për trafikim droge, në këtë rast, avokatët e të akuzuarve kanë kërkuar që të mos lexohet aktakuza, edhe Gjyqtari ka vepruar kështu. Ne jemi të vetëdijshëm për të drejtën e të akuzuarve për të mos u lexuar aktakuza, por jo edhe në rastet e shqyrtimit fillestar sepse aty është e obligueshme.

Kështu është tentuar të veprohet edhe në një rast tjetër në Ferizaj me numër të lëndës Pkr. 295/09, në rastin ku i akuzuar është B.M. Në këtë rast gjyqësor, avokatët mbrojtës kanë kërkuar nga Gjyqtari që të mos lexojë aktakuzën, por pala e dëmtuar ka kundërshtuar këtë duke kërkuar që aktakuza të lexohet, avokatët e të akuzuarve kanë thënë që kjo është e drejtë e të akuzuarve që të heqin dorë nga leximi i aktakuzës, por kanë harruar se kjo nuk vlen për shqyrtimin fillestar. Fatmirësisht, në këtë rast, pas ndërhyrjes së palës së dëmtuar, aktakuza është lexuar. Konsiderojmë që kjo tendencë është me qëllim të pengimit të medias për informim sa më të drejtë lidhur me veprën për të cilën akuzohen të pandehurit e caktuar.

Me gjithë atë sa u tha më sipër, vihet re se shkeljet procedurale janë akoma evidente nëpër seancat gjyqësore. Arsyetimi i vitit të kaluar se gjykatësit dhe prokurorët kanë nevojë për trajnime shtesë me rastin e ndryshimeve të Kodit Penal dhe atij të Procedurës Penale, këtë vit nuk qëndron, andaj mbetet shqetësues fakti i numrit të madh të shkeljeve të evidentuara në procedurën e proceseve gjyqësore.

IV. NUMRI I GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE

Sistemi gjyqësor, konkretisht gjykatat, duke qenë përfaqësueset e jetësimit të parimit të drejtësisë, si një nga tre shtyllat kryesore të shtetit tonë, më shumë se çdo gjë tjetër, duhet të kenë funksionalitet, i cili do të sigurojë një realizim efikas të detyrave që paraqiten si një sfidë para tyre.

Në grupin e elementeve të domosdoshme për të arritur deri tek një funksionalitet i kënaqshëm i gjykatave tona, përveç tjerash, janë kuadrot (stafi profesional) i tyre, para të cilëve paraqiten të gjitha detyrat për gjykim të drejtë, të shpejtë dhe të paanshëm. Fluksi i lëndëve të reja të paraqitura në gjykatë dhe i lëndëve të akumuluar që presin radhën për gjykim, janë një element negativ, që shton presionin dhe mund të ketë ndikim stresues dhe negativ në punën e gjykatësve aktual, të cilët për shkak objektiv dhe mbingarkesës nga lëndët e shumta, nuk mund të arrijnë funksionalitetin e duhur. Kjo ndodh për shkak të nevojave urgjente të zgjidhjes së rasteve të akumuluar në gjykata, të cilat kërkojnë prioritet në zgjidhjen e tyre, por njëkohësisht lëndët e reja të paraqitura, nuk duhet të neglizhohen.

Në të shumtën e rasteve, lëndët e zgjidhura nga gjykatësit tejkalojnë normën e përgjithshme normale, megjithatë mbetet një amulli në mbarëvajtjen e punëve në gjykata, gjithmonë për arsye të mungesës së gjykatësve në gjykatat tona. Me gjithë përpjekjet për procedura të shpjeta të shqyrtimeve dhe zgjidhjeve të rasteve, për minimizimin e shpenzimeve (parimi i ekonomizimit), për korrektësi, paanësi dhe përkushtim, këto detyra bëhen më se të vështira, kur secilit gjykatës për person i ndahet një numër pothuajse i papërballueshëm i lëndëve. Që të arrihet të jetësohet në maksimum parimi se gjykata është shtyllë e drejtësisë dhe efikasitetit, duhet të shmangen apo përmirësohen shkaqet që shkaktojnë vonesa dhe zvarritje, pamundësi për qasje të detajizuar

ndaj rasteve, e kjo mund të arrihet me një rritje të numrit të gjykatësve, bashkëpunëtorëve profesional dhe të prokurorëve.

Me rritjen e numrit të gjykatësve, bashkëpunëtorëve profesional dhe të prokurorëve, do të arriheshin kushtet që secilët prej tyre, të performonin maksimalisht detyrat që janë në kompetencë të tyre në bazë të kornizës ligjore, duke ushtruar kështu me profesionalizëm dhe korrektësi obligimet, e në këtë mënyrë e tërë hallka e sistemit të drejtësisë të funksionojë në koordinim të plotë dhe të ketë rezultate nga të cilat do të përfitonte shteti ynë dhe qytetarët tanë.

Për problemet dhe pasojat negative që po shkakton mungesa e tillë në kuadrot e gjykatave dhe prokurorëve, janë bërë konstatime nga gjendja reale në gjykatat dhe prokuroritë tona kryesore, ku ankesat kryesisht kanë të bëjnë me pasojat që vijnë nga mungesat e tilla, e që mund ti ndajmë kështu:

- Si pasojë e mungesës së gjykatësve dhe bashkëpunëtorëve profesional shkaktohet: Zvarritje e procedurave, pamundësi për zvogëlimin e numrit të akumuluar të lëndëve në gjykata, vjetërsimi/parashkrimi i lëndëve, rritja e pakënaqësive nga ana individëve që janë palë në çështje të caktuara dhe për shkak të procedurave mbeten në pritje ...etj
- Si pasojë e numrit të pamjaftueshëm të prokurorëve shkaktohen: Probleme në caktimin e seancave për shkak se prokurorët e njejtë marrin ftesë nga gjykata/tës (degë) të ndryshme në të njëjtën kohë, duke u shkakuar kështu vonesa dhe shtyerje të seancave. Problem tjetër për shkak të kësaj mungese haset edhe në pamundësinë e përpilimit të aktakuzave.

Nëqoftëse gjykatat do të kishin numër të mjaftueshëm të bashkëpunëtorëve profesional,

atëherë gjykatësit do të arrinin që të bënin shqyrtimet dhe marrjen e vendimeve në afate kohore më të shpjeta, me një efikasitet dhe lehtësi më të madhe.

Nëqoftëse të gjitha Prokuroritë Themelore, do të kishin prokurorë të mjaftueshëm në të gjitha departamentet, e veçanërisht në Departamentin e Përgjithshëm, nuk do të shkaktoheshin shtyerje të seancave, madje as vonesa e tyre, përshkak se nuk do të kishte fluks/ngarkesë të rasteve për prokurorët ngase koordinimi Gjykatë-Prokurori, do të ishte në nivelin e duhur duke mos tejkaluar normat, siç ndodh zakonisht.²⁵

Monitoruesit e BIRN-it, në monitorimet e tyre të rregullta në Gjykatat e Kosovës, kanë theksuar se në të gjitha nivelet, ekziston një nevojë urgjente për shtim të kuadrove, veçanërisht në gjykatat me fluks të shtuar të numrit të lëndëve dhe kërkesa kryesore qëndron në shtimin e bashkëpunëtorëve profesional, sepse gjendja aktuale paraqet një numër të papërfillshëm të tyre në krahasim me atë që është rekomanduar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (1 Bashkëpunëtor profesional për dy gjyqtarë).

Si shkak i gjendjes së tanishme në kuadrot e Gjykatave tona Themelore, ekziston nevoja për intervenim të menjëhershëm për shtimin e tyre dhe nevojat/propozimet thelbësore në gjykatat kryesore konsistojnë:

- Gjykata Themelore në Prizren, ka mungesë të kuadrove dhe bashkëpunëtorëve profesional. Për shkak se dy nga gjyqtarët kanë ndërruar jetë dhe një prej tyre ka lëshuar pozitën në fjalë dhe nevojën për të shtuar së paku 2 tjerë, konkludohet në një rritje prej së paku 5 gjyqtarëve. Për shkak të ndryshimeve të pozitave apo largimeve të bashkëpunëtorëve profesional, rrezikojnë të mbesin me numër minimal të tyre. Nevoja e madhe për bashkëpunëtorë në këtë gjykatë (bashkë me degët e kësaj gjykate), imponon për një numër prej së paku 15 bashkëpunëtorëve profesional.

E njëjta gjendje e mungesës së kuadrove të tillë qëndron edhe në Gjykatën Themelore të Gjilanit, ku gjithashtu janë konstatuar mungesa të bashkëpunëtorëve profesional dhe nevoja për rritjen e menjëhershme të numrit të tyre.

- Gjykata Themelore e Mitrovicës – me numër të gjyqtarëve, qëndron në një gjendje më të mirë se gjykatat tjera, por problemi qëndron në numrin e bashkëpunëtorëve profesional, të cilët i kanë gjithsej 3 (sepse 2 janë larguar) e kjo vështirëson punën e gjykatësve. Është potencuar se kjo gjykatë ka nevojë së paku për 15 bashkëpunëtorë. Problemi tjetër që has kjo gjykatë, është prezenca e Prokurorëve në seanca (konkretisht vonesat e tyre, për shkak të pamundësisë që shkaktohet nga numri i madh i rasteve që atyre u paraqiten në të njëjtën kohë). Veçanërisht hasen probleme në përpilimin e aktakuzave.
- Gjykata Themelore në Pejë – has në po të njëjtat probleme për shkak të mungesës së gjyqtarëve, konkretisht 1 në Pejë dhe një në Klinë, pra fillimisht të bëhet plotësimi i numrit të gjyqtarëve që u mungon. Problem tjetër që po shkakton shumë vështirësi, është numri i vogël i prokurorëve, e këto probleme sjellin vështirësi veçanërisht në degët: Klinë, Deçan dhe Istog. Në këto degë ka nga një në secilën prej tyre dhe ndjehet nevojë që po në secilën prej tyre të shtohen edhe nga dy bashkëpunëtorë profesional.
- Gjykata Themelore në Gjakovë, bashkëngjitur gjithë gjykatave të lartcekura, është e prekur gjithashtu nga mungesa e numrit të bashkëpunëtorëve profesional. Kjo gjykatë ka gjithsej 4 (një prej të cilëve mund të largohet eventualisht). Për shkak të fluksit të lëndëve dhe vështirësive të gjykatësve gjatë punës, ndjehet nevojë për shtimin e 3 bashkëpunëtorëve të tjerë. Në degët Rahovec dhe Malishevë, në secilën prej tyre është nga 1 bashkëpunëtor profesional. I vetmi bashkëpunëtor profesional në Rahovec, konstatohet sa mund të ndodh largimi i tij dhe theksohet që të shtohet edhe një bashkëpunëtor tjetër, kurse në Malishevë të

25 Ky është rekomandim i marrë nga gjykatësit e gjykatave themelore

shtohen 2 bashkëpunëtorë të tjerë përveç njërit që tashmë është. Në këtë gjykatë – Gjkata Themelore në Gjakovë, deri më tani 6 gjykatës kanë lënë detyrat e tyre (duhet të plotësohen këto vende të liruara) dhe të shtohen 2 gjykatës shtesë, që të arrihet një menaxhim dhe trajtim më i shpejtë i numrit të madh të lëndëve. Në degët në Rahovec dhe në Malishevë, janë konstatuar të njëjtat probleme, ku në Rahovec prej gjithsej 6 gjykatësve 3 prej tyre pritet të arrijnë moshën e duhur për pension dhe është potencuar nevoja që përveç numrit të 6 gjykatësve të shtohet edhe një tjetër kurse dega në Malishevë ka 4 gjykatës dhe është potencuar nevoja për të shtuar edhe një tjetër. Kjo gjykatë ka probleme edhe me vonesën e prokurorëve dhe vërehet një nevojë për rritjen e tyre, madje në proporcion 1 me 1, një prokuror për një gjykatës.

- Gjkata Themelore në Ferizaj – ndjen një nevojë të pashmangshme në rritjen konkretisht dyfishimin e numrit të gjykatësve. Aktualisht kjo gjykatë ka 15 gjykatës dhe vërehet një nevojë e menjëhershme për rritjen e numrit të tyre.

Të gjitha nga gjykatat e lartpërmendura, këtë problem e kanë në vazhdimsi për vite të tëra dhe ky problem është i njohur edhe nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (tash e tutje KGJK). Nga informacionet e marra nga KGJK-ja, në të gjitha nivelet e gjykatave të Republikës së Kosovës, me datë 31 Dhjetor 2014 ishin 317 gjyqtarë, duke përfshirë edhe 11 gjyqtar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.

Në Shkurt 2015 numri i gjyqtarëve në të gjitha nivelet e gjykatave është 316. Nga e gjithë pasqyra e monitorimit në gjykata, nga qëndrimet e vet gjykatave që kërkojnë shtim të gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional, është e dukshme që ky numër është i pamjaftueshëm për të arritur në një nivel pune më të kënaqshëm të gjyqsorit.

Me buxhetin mbi gjykatat, sipas KGJK-së është paraparë që numri i gjyqtarëve të jetë 404 (duke përfshirë këtu edhe 12 gjyqtarë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme).

Për të zbutur ngarkesën dhe presionin që po u shkaktohet gjyqtarëve aktual, KGJK-ja në informacionet e dhëna, njofton që në procedurë të rekrutimit janë rreth 40 gjyqtarë dhe pritet që ata të fillojnë punën në Gjykatat e Republikës së Kosovës.

Nëqoftëse procedura e rekrutimit përfundon shpejtë (sepse rekrutimi u vonua për shkak të mungesës së fondeve), 40 prej gjyqtarëve që do të fillonin punën pas përfundimit të kësaj procedure, do të ndihmonin në zbutje të kësaj ngarkese (në pikëpamjen e një shqyrtimi më të madh të lëndëve duke zvogëluar kështu numrin e tyre të madh të grumbulluar në të gjitha Gjykatat Themelore), por që megjithatë për një përmirësim efikas, do duhej që brenda një afati kohor të shpejtë të ndërmerreshin hapa për plotësimin e numrit të gjyqtarëve, së paku deri në normën e paraparë me buxhetin mbi gjykatat, pra në 404.

Përveç kësaj, KGJK-ja gjithashtu është në dijeni për numrin e vogël të bashkëpunëtorëve profesional nëpër gjykatat tona, (sipas informimit nga KGJK gjithsej 98), por që potencohet se për shkak të kufizimeve buxhetore, numri i tyre nuk mund të rritet. Po të merret parasysh një njoftim i tillë, se për shkaqe të financave, numri i bashkëpunëtorëve do të mbetet i njejtë sa është aktualisht, në mënyrë të menjëhershme kuptojmë se gjyqësorin do ta përcjellin në vazhdimsi problemet të cekura në pjesën e mësipërme të analizës, e veçanërisht me këto do të përballen gjyqtarët, të cilët kanë nevojë të menjëhershme për bashkëpunëtorë, nevojë kjo e cila nuk do të mund t'u përmbushet duke rrezikuar kështu vazhdimin e vonesave në procedurë dhe parregullsive të tjera.

Që hallkat e sistemit të drejtësisë të funksionojnë saktë dhe dobishëm, e kemi përmendur si faktor koordinimin e duhur mes tyre e rol të rëndësishëm këtu luan edhe funksionimi i rregullt nga ana e Prokurorive Themelore të Kosovës.

Duket se mungesa e kuadrove, nuk është problem që ka prekur vetëm gjykatat, por nga gjendja faktike, kuptojmë se po me të njëjtin problem përballen të gjitha Prokuroritë Themelore, e që

fatkeqësisht, interferohet me pasoja negative në të gjitha seancat e mbajtura në gjykata, duke shkaktuar vonesa e shtyerje të tyre. Pothuajse çdo prokuror i Prokurorive Themelore, ka numër të shumëfishuar të lëndëve të ndara për ta, duke e bërë kështu të pamundur koordinimin me gjykatat, arritjen me kohë në seancat e ftuara, përpilimin e rregullt të aktakuzave dhe përkushtimin e duhur ndaj të gjitha lëndëve.

Se këto prokurori, kanë mungesë të theksuar të prokurorëve, mund ta shohim edhe nga numri i saktë i tyre, si vijon:

- **Prokuroria Themelore në Prishtinë**, ka gjithsej 41 prokurorë , prej të cilëve 22 janë meshkuj ndërsa 19 janë femra. 40 nga prokurorët janë shqiptarë dhe 1 nga komuniteti serb. Numrin më të vogël të prokurorëve e hasim në Departamentin për të mitur.
- **Prokuroria Themelore në Prizren**, ka gjithsej 12 prokurorë , prej të cilëve 6 janë meshkuj ndërsa 6 janë femra.
- **Prokuroria Themelore në Pejë**, ka gjithsej 14 prokurorë , prej të cilëve 7 janë meshkuj ndërsa 7 janë femra. Gjithsej 13 prokurorë janë shqiptarë dhe 1 nga komuniteti boshnjak
- **Prokuroria Themelore në Mitrovicë**, ka gjithsej 10 prokurorë, prej të cilëve 5 janë meshkuj ndërsa 5 janë femra. Në tërësi 8 prokurorë janë shqiptarë, 1 nga komuniteti boshnjak dhe një nga komuniteti turk.
- **Prokuroria Themelore në Gjilan**, ka gjithsej 16 prokurorë , prej të cilëve 12 janë meshkuj ndërsa 4 janë femra.
- **Prokuroria Themelore në Gjakovë** ka gjithsej 11 prokurorë, prej të cilëve 8 janë meshkuj ndërsa 3 janë femra.
- **Prokuroria Themelore në Ferizaj** ka gjithsej 11 prokurorë, prej të cilëve 10 janë meshkuj ndërsa 1 është femër.
- **PROKURORIA E SHTETIT** - Gjithsej 3 Prokurorë , 2 meshkuj dhe 1 femër.
- **PROKURORIA E APELIT** - Gjithsej 8 Prokurorë, 7 meshkuj dhe 1 femër prej të cilëve 7 janë shqiptarë dhe 1 i komunitetit boshnjak.
- **PROKURORIA SPECIALE** – Gjithsej 13 Prokurorë, 10 meshkuj dhe 3 femra prej të cilëve 12 janë shqiptarë dhe 1 i komunitetit boshnjak.

Numri aktual i Prokurorëve në Prokurori (konkretisht deri me datë 23.02.2015) është gjithsej 139 Prokurorë, prej të cilëve 89 janë meshkuj dhe 50 janë femra. Shqiptarë janë gjithsej 133 Prokurorë, të komunitetit serb janë 2, komunitetit boshnjak 3 dhe të komunitetit turk 1.

Nga pasqyra e lartëcekur e kuadrove të Prokurorive Themelore të Kosovës, vërehet qartë numri i prokurorëve është mjaft i vogël, deri në pamjaftueshmëri, e kur të merret parasysh fakti që të njëjtit prokuror ftohen në të njëjtën kohë në seanca të ndryshme në Gjykata Themelore e duke i shtuar kësaj edhe ftesat nga degët e gjykatave, mund të konkludojmë që është e pamundur që një prokuror i vetëm të menaxhojë, përcjellë dhe të jetë prezent në të gjitha shqyrtimet ku është ftuar.

Një mbingarkesë e tillë e prokurorëve, për shkak të numrit të madh të lëndëve, po shkakton çrregullim në të gjithë sistemin gjyqësor, e kjo është konstatuar nga vetë shprehja e shqetësimeve nga gjyqtarët. Një shembull nga problemet e shumta që po shkaktohet si pasojë e numrit të vogël të kuadrove në të gjitha Prokuroritë Themelore, është ai që haste në degët e Gjykatës Themelore të Gjilanit, konkretisht në Gjykatat e Kamenicës, Vitisë dhe Novobërdës, gjykata këto të cilat gjykojnë çështje penale një ditë të vetme në javë, për shkak se Prokuroria nuk u'a dërgon prokurorët gjatë ditëve të tjera, kur këta kanë nevojë. Dallohet qartë dëmi që pëson relacioni Gjykatë – Prokurori, për shkak të kësaj mungese, e gjithashtu çdo qytetar i cili është palë e procedurës, preket nga këto probleme të sistemit tonë gjyqësor, duke u shkaktuar kështu një pakënaqësi kolektive dhe ulje e besimit në institucionin themelor të gjyqësisë – në Gjykata.

Nga konstatimet e kryeprokurorëve të Prokurorive Themelore, është potencuar që ekziston një frymë e mire bashkëpunimi me Këshillin Prokurorial të Kosovës (tutje KPK) dhe se po haset një gatishmëri shprehimore nga ana e këtij institucioni, mirëpo pa ndonjë ndryshim efektiv, sepse numri në këto prokurori mbetet i njejtë, por edhe nëse do të ndryshohet në bazë të planit të KPK-së, do të ishte sërish i pamjaftueshëm për t'u bërë një përmirësim i dukshëm dhe efikas në kuadrot e Prokurorive Themelore, që për pasojë do të kishte zvogëlimin e normës së lëndëve për secilin prej prokurorëve aktual sepse këto Prokurori kanë nevojë deri në dyfishimin e stafit- konkretisht kuadrit të prokurorëve.

Gjendje problematike është konstatuar veçanërisht në Prokurorinë Themelore të Prizrenit dhe Prokurorinë Themelore të Pejës, pas analizimit të gjendjes faktike (veçanërisht vështrimeve nga ana e gjykatave dhe raportet e tyre me prokurorë).

Në Prokurorinë Themelore të Prizrenit, janë hasur vështirësi dhe numër të lëndëve të papërbalueshme, në masë të theksuar në Departamentin e Përgjithshëm. Duke u varur nga nevoja për një menaxhim më të shpejtë dhe efikas të lëndëve, është ndërjerë një urgjencë për rritje të numrit të prokurorëve, pra të shtohen 4 apo 5 prokurorë të rinjë.

Prokuroria Themelore e Pejës, gjithashtu ka probleme me numër të pamjaftueshëm të prokurorëve, veçanërisht në Departamentin për të Mitur, kur një prokuror e tejkalon normën e zakonshme të lëndëve për 4 fish, gjë që e bënë të pamundur punën. Departamenti i Përgjithshëm, ka të njëjta probleme dhe përmirësimi do të mund të bëhej nëse do të zbatohet propozimi që numri i prokurorëve të barazohet me numrin e gjyqtarëve në Gjykatën Themelore të Pejës (bashkë me degët).

Prokuroria Themelore e Prizrenit dhe ajo e Pejës, janë përzgjedhur si shembull ilustrues, për të bërë të qartë mangësitë dhe mungesat që hasen në të gjitha Prokuroritë e tjera, e që në mënyrë direkte komplikon dhe ngadalëson punën e gjykatave, të cilat për mbarëvajtjen e procedurave duhet të kenë një koordinim dhe

bashkëpunim të mire, ashtu siç edhe është përcaktuar me kornizën ligjore, për shkak të rëndësisë që ka secili organ veç e veç në paraqitjen e provave, shqyrtimin dhe marrjen e vendimit për çështjet e shqyrtuara.

Nga gjithë çfarë u cek më lartë, si emërues i përbashkët për shkakun e problemeve në sistemin e Gjykatave dhe Prokurorive, qëndron mungesa e kuadrove dhe nevoja për përpjekje të menjëhershme nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, në rritjen e numrit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Pasi KGJK-ja dhe KPK-ja theksojnë se janë në dijeni për problemet që po hasin në sistemin gjyqësor dhe se pavarësisht gatishmërisë për të ndërhyrë drejtë një përmirësimi në këtë gjendje, kjo po pamundësohet për shkak të buxhetit, atëherë hapet rruga për kërkim të alternativave të mundshme, që do të bënin të mundur gjetjen e një mënyre përmes së cilës do të arrihej ajo që për shkak të kufizimeve buxhetore, nuk po bëhet, edhe pse janë vërtetuar dëmet që po shkaktohen si pasojë të kësaj.

Në vazhden e analizimit të gjendjes, mundësive dhe pamundësive për ndryshimin apo përmirësimin e kësaj gjendjeje është i nevojshëm një rekomandim për propozim të ndonjë alternative që do të mund të jepte rezultat, e kjo është:

Krijimi i pozitave të lira nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (pozita për gjyqtarë dhe bashkëpunëtorë profesional), duke e bartur stafin e sigurimit të gjykatave në përgjegjësi të kompanive private. Sipas informatave, janë diku rreth 300 zyrtarë që bëjnë sigurimin e ndërtesave dhe nëse ata nuk do të paguheshin nga linja buxhetore (paga dhe mëditje), atëherë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, do të mund të angazhonte staf shtesë për praktikantë dhe bashkëpunëtorë profesional. E konsiderojmë një alternative të tillë të arsyeshme për shkak të pamundësisë financiare/buxhetore, e nëse një menaxhim më i arsyeshëm me mjetet ekzistuese, do të mund të krijonte mundësi për rritje të bashkëpunëtorëve profesional, kjo tregon se përmirësimet të vogla por të dobishme do të mund të bëheshin në sistemin gjyqësor kosovar.

V. VENDIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE QË NGJALLI DISKUTIME²⁶

Vazhdimi i mandatit të gjykatësve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Ri-emërimi dhe Vazhdimi i Mandatit

Në shikim të parë, duke u bazuar në vet titullin e kësaj analize ligjore, cdo jurist do të reagojë nga ky titull me arsyetimin se si është e mundur që në Gjykatën Kushtetuese të ketë riemërim, e aq më tepër vazhdim të mandatit?!

Duke u bazuar në këtë fakt, gjejmë të arsyeshme fillimisht të sqarojmë mandatin e gjykatësve të emëruar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, përjashtimet e parapara me Kushtetutë për emërimin e gjykatësve ndërkombëtarë dhe poashtu edhe vendimin e fundit për ri-emërim dhe vazhdim të mandatit të gjykatësve të EULEX-it me dekret të Presidentes së vendit.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese, përbëhet nga nëntë gjykatës, të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi.²⁷

Kushtetuta e Kosovës, e hyrën në fuqi më 15 qershor 2008, ka paraparë edhe dispozita kalimtare, kjo për shkak të mbikqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Në këtë drejtim me dispozita kalimtare është paraparë edhe mandati i gjykatësve ndërkombëtarë të cilët nuk do të emëroheshin nga presidenti, por nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, i cili duhej

të vendoste për gjykatësit ndërkombëtarë, pas konsultimit me kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Tre gjykatësit nuk duhej të ishin qytetarë të Kosovës dhe as të ndonjë vendi fqinj.²⁸

E drejtë ekskluzive e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, sipas dispozitave kalimtare të Kushtetutës së Kosovës, ishte që të përcaktojë se kur u skadon mandati i gjykatësve ndërkombëtarë. Në bazë të këtyre dispozitave, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë, më 12 qershor 2009, emëroi tre gjykatës ndërkombëtarë, për një mandate tre vjeçar.²⁹

Rreth pesë muaj para përfundimit të mandatit të këtyre gjykatësve ndërkombëtarë, pak ditë para përfundimit të mbikqyrjes ndërkombëtare, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, riemëroi tre gjykatarët për mandatin e dytë deri më 31 gusht 2014.

Përjashtim në mandatin e gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese, sic shihet është bërë sa u përket gjykatësve ndërkombëtarë. Mirëpo, edhe përkundër këtyre përjashtimeve, askund në Kushtetutën e Kosovës, nuk parashihet termi riemërim, apo vazhdim i mandatit të Gjykatësve, qofshin ata vendor apo ndërkombëtarë.

E drejta për emërimin e gjykatësve ndërkombëtarë i garantohej Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar me dispozitat kalimtare kushtetuese, deri në përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur ndërkombëtare, e cila përfundoi më 10 shtator 2012. Mirëpo, Presidentja

26 Kjo analizë është bërë gjatë Dhjetorit 2014

27 Kushtetuta e Kosovës, neni 114, pika 2.

28 Po aty, shih neni 152 pika 4

29 Gjykatësit e emëruar nga PCN, ishin: Robert Carolan, Snezhana Botusharova-Diocheva dhe Almiro Simoes Rodrigues.

e vendit, me dekret, vazhdoi mandatin e gjykatësve ndërkombëtarë edhe pas përfundimit të mandatit të tyre të vazhduar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, e aq më tepër, pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur ndërkombëtare.

Përfundimi i Pavarësisë së Mbikëqyrur

10 shtatori i vitit 2012, shënoi përfundimin e një kapitulli dhe fillimin e një kapitulli të ri për Kosovën. Nga shtatori i vitit 2012, përfundoi mbikëqyrja e pavarësisë së Kosovës, bashkë me të përfundoi edhe mandati i Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, si fuqi juridike e lartë dhe e vecantë, nga kjo datë u hap kapitulli i ri për institucionet vendore, bashkë me to u shtuan edhe përgjegjësitë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës tani përbën bazën kryesore të kornizës juridike të vendit.

Pas skadimit të mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë, më 31 gusht 2014, Presidentja Jahjaga nxori Dekretin Nr. DKGJK-001-2014, për konfirmimin e vazhdimit të gjykatësve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, mirëpo vazhdimi i mandatit të tyre u bë pa marrë propozim nga Kuvendi i Kosovës³⁰, ashtu sic parashihet në pikën 11 të nenit 65 në të cilin thuhet se Kuvendi i Republikës së Kosovës ka kompetencë “të propozoj gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese” dhe në pikën 2 të nenit 114 të Kushtetutës së Kosovës, thuhet: “Gjyqtarët

emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi”.

Përfundimi i mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, solli edhe amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ekzistimi i amendamentit 13 përmes të cilit ishte shfuqizuar neni 152 i Kushtetutës³¹ që i referohej përbërjes së përkohshme të Gjykatës Kushtetuese, përbën qartë ndalesë për të realizuar zgjedhjen e Gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese nga ana e një organizate ndërkombëtare, që do të thotë praktikisht mos-vazhdim i prezencës ndërkombëtare në këtë gjykatë.

Në rastin konkret, vazhdimi i mandatit të tre gjykatësve ndërkombëtarë, edhe pas ndalesave kushtetuese, e kthen Republikën e Kosovës mbrapa edhe në kuptimin politik, për shkak të procesit të përmbylljes së mbikëqyrjes ndërkombëtare. Ky proces, që u finalizua në shtator të vitit 2012, synonte heqjen e prezencës ndërkombëtare në institucione, përfshirë këtu edhe gjykatësit ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese.

Marrë parasysh faktin se Kushtetuta përcakton në mënyrë eksplicite se, emërimi i gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese mund të bëhet vetëm me propozimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës³², ky anashkalim kushtetues nuk mund

30 Dekreti i Presidentes së Republikës së Kosovës, dokument i siguruar me kërkesën e BIRN për qasje në dokumente publike, datë 29.09.2014, me numër protokoli 764

31 Neni 152 i Kushtetutës së Kosovës; “Përbërja e Përkohshme në Gjykatës Kushtetuese. Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, Gjykata Kushtetuese do të përbëhet si në vijim:

1. Gjashtë nga nëntë gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës më propozimin e Kuvendit.
2. Nga gjashtë gjyqtarët, dy do të shërbejnë për një mandat trevjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, dy do të shërbejnë për një periudhë gjashtëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes. Mandatet e gjyqtarëve fillestarë do të zgjidhen me short, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, menjëherë pas emërimit të tyre.
3. Nga gjashtë gjyqtarët, katër do të zgjidhen me votat e 2/3 të deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë. Dy do të zgjidhen me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, pas pëlqimit të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet që janë rezervuar ose garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
4. Tre gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil pas konsultimit me kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Tre gjyqtarët nuk do të jenë qytetarë të Kosovës dhe as të ndonjë vendi fqinj.
5. Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, do të përcaktojë se kur skadon mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë, dhe gjyqtarët do të ndërrohen sikur është e parashikuar me Kushtetutë”.

32 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 65 pika 11 dhe neni 114 pika 2.

të justifikohet me dekret të Presidentes, në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare në formë letërkëmbimi midis Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, e ratifikuar më 23 prill 2014, në të cilin letërkëmbim, ndër të tjera nga Presidentja, thuhet:

...pas përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë, EULEX-i mund të emërojë gjyqtarë dhe prokurorë të tij, të cilët do t'i zëvendësojnë ata të cilëve u skadon mandati. Këto emëime kryhen sipas mënyrës së përshkruar në vijim: Sipas nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, unë kam fuqinë të emëroj dhe shkarkoj prokurorët dhe gjyqtarët sipas propozimit të trupave nominues. Neni 20 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i lejon Republikës që t'ia bëjë delegimin e kompetencave të caktuara organizatave ndërkombëtare për disa çështje specifike

Mënyra e gjetjes së kësaj zgjidhje, duke marrë parasysh natyrën e letrës, e cila është jashtë natyrës kushtetuese, ndër të tjera përbën edhe një paaftësi institucionale për të konsoliduar institucionet, në këtë rast Gjykatën Kushtetuese, por njëherësh edhe një përshtatje të aktit më të lartë me rrethanat politike.

Bartja e Sovranitetit

Sipas pikës 1 të nenit 20 të Kushtetutës së Kosovës, i lejohej Republikës së Kosovës, që në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara, për çështje të caktuara mund të kalojë kompetenca shtetërore organizatave ndërkombëtare. Një veprim të tillë ndër morri Presidentja e vendit, me të cilin i barti kompetencat tek Eulex Kosova, për vazhdimin e mandatit të tre gjykatësve ndërkombëtarë.

Në letërkëmbimin e Presidentes së Republikës së Kosovës me Baroneshën Ashton, të datës 14 prill 2014, ndër të tjera Presidentja, si

përfaqësuese e shtetit në këtë rast, shprehu vullnetin e saj që në bazë të nenit 20 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të bëjë bartjen e disa kompetencave, të ashtuquajtura për çështje specifike.

Mirëpo, bartja e kompetencave tek Eulex Kosova nga Presidentja e vendit, sa ishte i drejtë, nga fakti se misioni dhe detyrat e Eulex-it, janë të përcaktuara me Veprimin e Përbashkët, të miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian në vitin 2008, sipas të cilit Eulex-i mund të veproj vetëm brenda institucioneve të krijuara në bazë të rezolutës 1244.

Meqenëse Gjykata Kushtetuese, nuk është institucion i krijuar në bazë të rezolutës 1244, është e qartë se kompetenca për të emëruar gjykatësit e kësaj gjykate nga Eulex-i, do ta sillte Eulex-in jashtë kornizës së Veprimit të Përbashkët, ngase Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e rregulltë, sic janë Gjykatat dhe Prokuroritë e rregullta në të cilat ka ofruar asistencë misioni i Eulex-it.

Shikuar nga prizmi tjetër, logjika e kësaj bartje të kompetencës për emërimin e tre gjykatësve ndërkombëtarë, në Gjykatën Kushtetuese, nuk do mend që lidhet direkt me situatën e krijuar dhe me pamundësinë që parlamenti t'i zëvendësojë këta gjykatës me vendor, sipas mënyrës dhe procedurës së rregullt.

E thamë, se bartja e kompetencave është e shëndoshë, këtë e parasheh Neni 20 i Kushtetutës së Kosovës, mirëpo janë dy çështje në kuadër të të cilave duhet të shihet kjo kërkesë në rastin konkret. E para ekzistimi i një amendamenti Kushtetues³³, që ka hequr përbërjen ndërkombëtare në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe e dyta, kjo mënyrë e zgjidhjes së çështjes na kthen në gjendjen e para përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Mbi të gjitha letra e presidentes Jahjaga, pretendon t'i delegojë Eulex-it, vetëm kompetencën e emërimit të gjykatësve, jo

33 Amendamenti 13.

edhe kompetencën e propozimit të tyre, e cila kompetencë ende mbetet e garantuar për Kuvendin e Kosovës, nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.³⁴

Hierarkia e Ligjeve në Republikën e Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 19, përcakton modalitetet e zbatimit të së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht raportin e ligjeve të Kosovës me marrëveshjet ndërkombëtare. Edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në linjë me parimet e së drejtës ndërkombëtare, njeh epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare në raport me ligjet e Republikës së Kosovës.

Gjykatat Kushtetuese të vendeve të rajonit kanë një rol të ngjashëm me atë të Kosovës përkitazi me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Psh, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, sipas Kushtetutës së Kroacisë, nuk ka ndonjë kompetencë për të vlerësuar marrëveshjet ndërkombëtare. Kjo është përcaktuar edhe në Vendimin U-I/1583/2000, ku Gjykata Kushtetuese e Kroacisë refuzoi kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë së një ligji për ratifikim të miratuar nga ligjvënësit. Por, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë konstatoi se është kompetente për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktit për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare, por jo edhe për vlerësimin e vetë marrëveshjes ndërkombëtare, që është pjesë përbërëse e aktit të ratifikimit.

Edhe Kushtetuta e Sllovenisë përcakton epërsinë e Kushtetutës në raport me të drejtën ndërkombëtare, për më tepër, sa i përket Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, neni 160 [Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese] përmban dispozita relevante përkitazi me marrëveshjet ndërkombëtare.

Më konkretisht, paragrafi 2 i nenit thotë:

“Në procesin e ratifikimit të marrëveshjeve, Gjykata Kushtetuese, me propozim të Presidentit të Republikës, të Qeverisë ose të një të tretës së deputetëve të Kuvendit Kombëtar, nxjerr mendim përkitazi me pajtueshmërinë e një marrëveshjeje me Kushtetutën. Mendimi i Gjykatës Kushtetuese është detyrues për Kuvendin Kombëtar”.

Në linjë me Kushtetutat e vendeve të rajonit, neni 19, par.1, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se marrëveshjet ndërkombëtare, pas ratifikimit dhe publikimit në Gazetën Zyrtare, bëhen pjesë e sistemit juridik të brendshëm dhe mund të zbatohen drejtpërdrejtë, e përjashtim nga kjo përbëjnë rasti kur zbatimin e tyre kërkohet nxjerrja e një ligji³⁵. I tillë, është edhe rasti me marrëveshjes së realizuar përmes letërkëmbimit të Presidentes Jahjaga me përfaqësuesen e lartë të BE-së, Catherine Ashton.

Ky letërkëmbim u ratifikua në Kuvendin e Kosovës, me 2/3 e votave të deputetëve të Kosovës, si ligji nr. 04/L-274, dhe si rrjedhojë e këtij ratifikimi, Presidentja e Kosovës nxorri Dekretin me nr.DKGJK-001-2014. Por, pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje, për shtjellim paraqitet raporti i kësaj marrëveshjeje me të drejtën e brendshme në Republikën e Kosovës. Neni³⁶ 19, par. 2, i Kushtetutës së Kosovës e rregullon, këtë raport. Kushtetuta jonë, njeh epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

Por, megjithatë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, qëndron më lartë se marrëveshjet ndërkombëtare dhe se marrëveshjet ndërkombëtare i nënshtrohen epërsisë së

34 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 65 pika 11

35 Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji

36 Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

Kushtetutës. Këtë, shumë qartë e përcakton edhe Gjykata Kushtetuese. Në vendimin (KO 95/13), lidhur me kërkesën e deputetit Visar Ymeri dhe të tjerët, Gjykata vë një standard juridik, duke përcaktuar se:

Dispozitat e një marrëveshjeje ndërkombëtare, që janë të vetëkërkueshme, janë të një rendi më të lartë juridik se legjislacioni i Kosovës, porse qëndrojnë në një rend juridik me të ulët se Kushtetuta e Kosovës, siç përcaktohet me nenin 19 të Kushtetutës së Kosovës.

Pra, mund të konkludojmë që në republikën e Kosovës, Kushtetuta, është dokumenti më i lartë juridik, së cilës, i nënshtrohen edhe marrëveshjet ndërkombëtare, e në rastin tonë, edhe marrëveshja e lidhur në mes së Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, e realizuar përmes letërkëmbimit të Presidentes me baroneshën Ashton.

Mirëpo, në anën tjetër, po në rastin KO 95/13, Gjykata përcakton se: *“asnjë nen i Kushtetutës nuk parasheh vlerësimin e kushtetutshmërisë së përmbajtjes së marrëveshjeje ndërkombëtare nga Gjykata Kushtetuese” par. 99 si dhe Gjykata vëren se “nuk është e autorizuar për të vlerësuar marrëveshjen ndërkombëtare, si të tillë në përputhje me Kushtetutën”.*

Duke krahasuar këto përfundime të Gjykatës, të gjetura në të njëjtin vendim, (KO 95/13), në mënyrë të natyrshme lind pyetja nëse një marrëveshje ndërkombëtare nuk është në pajtim me Kushtetutën, duke pasur parasysh që marrëveshjet ndërkombëtare i nënshtrohen Kushtetutës, atëherë nëse Gjykata Kushtetuese nuk vlerëson kushtetueshmërinë e marrëveshjeje ndërkombëtare, atëherë kush e bënë ?!

Mandati i EULEX-it

Misioni dhe detyrat e Misionit të BE-së, për Sundim të Ligjit Evropian në Kosovë, EULEX Kosova, janë të përcaktuara me Veprimin e Përbashkët (Joint Action), 2008/124/CFSP, të

miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian më 4 shkurt 2008. Veprimi i Përbashkët (Joint Action), përcakton qartë kompetencën e EULEX-it dhe raportin e tij me organet, institucionet dhe autoritetet e Kosovës. duke përcaktuar se: “Organet, institucionet dhe autoritetet e Kosovës, të përmendura në këtë Veprim të Përbashkët janë institucione të krijuara në bazë të Rezolutës 1244, të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të datës 10 qershor 1999.

Organet e Kosovës, institucionet, dhe autoritetet e përmendura në këtë Veprim të Përbashkët janë institucionet (më tej institucionet e Kosovës) të krijuara në bazë të Rezolutës 1244. Ato përfshijnë, ndër të tjera, Shërbimin Policor të Kosovës, gjyqësorin dhe ministritë shoqëruese të Drejtësisë.

Në Aneksin 1, pika 5, dhe Aneksin 2, pika 5, Rezoluta 1244 përcakton themelimin e administratës së përkohëshme e cila do të garanton kushte për një jetë paqësore dhe normale të qytetarëve të Kosovës. E në bazë të këtyre dispozitave, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm shpalli Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme, qëllimi i së cilës ishte krijimi i vetëqeverisjes në Kosovë deri në zgjidhjen përfundimtare dhe krijimi i institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në fushat legjislative, ekzekutive edhe gjyqësore.

Sipas Kornizës Kushtetuese, të nxjerrë në pajtim me Rezolutën 1244, përcaktohen institucionet dhe organet e Kosovës, duke përfshirë institucionet gjyqësore. Në listën e institucioneve që bëjnë pjesë në sistemin gjyqësor, në pjesën 4, 9.4.4, përcaktohen, Gjykata Supreme, Gjykatat e Qarqeve, Gjykatat Komunale, dhe Gjykatat për Kundërvajtje. Ajo që nuk paraqitet në listë është Gjykata Kushtetuese. Gjithashtu, sipas Kornizës Kushtetuese, Kosova nuk ka pasur ndonjë institucion apo organ pararendës të Gjykatës Kushtetuese. Madje, dispozitat e Kornizës Kushtetuese lidhur me sistemin gjyqësor nuk

përfshijnë ndonjë organ që në ndonjë mënyrë ka ushtruar rolin e Gjykatës Kushtetuese.

Veprimi i përbashkët, (Joint Action) është ndryshuar dhe plotësuar disa herë, fillimisht në vitin 2009, pastaj në vitin 2010, në vitin 2012 dhe në fund në vitin 2014. Por, të gjitha këto amandamentime që i janë bërë Veprimit të Përbashkët fillestar, (Council Joint Action, 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008), nuk e kanë ndryshuar mandatin e EULEX-it, e i cili përcaktohet qartë që është brenda kornizës ligjore të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara, pra Rezolutës 1244. Rrjedhimisht, mandati i misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë, EULEX, qartazi ka një pozicion neutral karshi statusit të Kosovës, dhe ky neutralitet nuk është modifikuar në asnjërin nga rastet e amandamentimeve që i janë bërë Veprimit të Përbashkët. Në anën tjetër, Gjykata Kushtetuese, është një institucion i drejtësisë, institucioni më i lartë i drejtësisë i Republikës së Kosovës, që kujdeset që të gjitha ligjet dhe aktet e tjera juridike të jenë në përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës. Emërimi, propozimi apo çfarëdo përfshirjeje e EULEX-it lidhur me gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, dhe Gjykatën Kushtetuese, një institucion ky, që është derivat dhe gardian i kushtetueshmërisë në Republikën e Kosovës, konsiderojmë se është jashtë kornizës ligjore të veprimit të EULEX-it në Kosovë.

Përveq kornizës ligjore të përcaktuar nga BE, edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës ka rregulluar përgjegjësitë e EULEX-it në Kosovë, me miratimin dhe ratifikimin e një sërë ligjesh, të cilat, së fundmi, janë ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-273 Për Ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës, i datës 23 prill 2014. Nga ky ligj, pa u thelluar fare në përmbajtjen e tij, vërejmë se ligji ngushton fushëveprimin ligjor dhe kompetencat e EULEX-it, në raport me ligjet fillestare që rregullonin fushëveprimin e EULEX-it.

A është dashur të shpallet kërkesa e papranueshme?

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 113 par. 2 si dhe Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës në nenin 29, parashohin se kush mund të ngris një çështje në Gjykatën Kushtetuese, për çështjen e përputhshmësisë së ligjeve, dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën.

Në bazë të këtyre dispozitave juridike, Avokati i Popullit dërgoi një kërkesë drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në çështjen: Shfuqizimin e Dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës nr.DKGJK-001-2014 të datës 31 gusht 2014 “për konfirmimin e vazhdimin të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës”.Kësaj Gjykate, Avokati i Popullit iu drejtua me pyetjen:

A mund të justifikohet ky devijim prej Kushtetutës në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare midis Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, të ratifikuar me datë 23 prill 2014?

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 29 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe në mbështetje të paragrafit (1), pika c), dhe të paragrafit (2) të rregullit 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, me 13 nëntor 2014, njëzëri vendosi të deklarojë kërkesën e Avokatit të Popullit si të papranueshme. Gjykata Kushtetuese, vendimin e morri duke u mbështetur në nenin 29 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Në këtë dispozitë, është paraparë saktësimi i një kërkesë kur i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Po ashtu Neni 29, i ligjit për Gjykatën Kushtetuese, në paragrafin 1 parasheh se kush ka të drejtë të ngrisë kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, e këtë të drejtë Avokati i Popullit e gëzon në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës së Kosovës. Në paragrafin 2, të po të njëjtit nen,

kërkohej që të specifikohet akti i kontestuar, nëse kontestohet në tërësinë e tij apo vetëm në një pjesë të tij, edhe në paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet që kërkesa të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

Avokati i Popullit, në kërkesën e tij parashtruar në Gjykatë, në mënyrë të prerë dhe të detajizuar ka përshkruar dhe saktësuar kërkesën e tij, ashtu që kushdo që do ta lexonte kërkesën mund të vërejë se Avokati i Popullit konteston “Dekretin për konfirmimin e vazhdimin të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës Kushtetuese”, një formulim ky, që askund në Kushtetutën e Republikës së Kosovës nuk ekziston. Dispozitë tjetër në të cilën është thirrur Gjykata në vendimin e saj, është edhe Rregulli 36, i Rregullores së Punës së Gjykatës, ku në par. (1) c) thuhet: “kërkesa parashtruhet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi”, kërkesa e Avokatit të Popullit e ka plotësuar këtë kriter, është dorëzuar në afatin paraparë.

Po ashtu në par. (2) të të njëjtit rregull, parashihet që:

Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: (a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose (b) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose (c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

Tani të analizojmë secilën nga pikat e paragrafit 2, të rregullit 36 të rregullores së Punës së Gjykatës. Pika a) parashihet që “kërkesa

nuk arsyetohet *Prima facie*” e që do të thotë se *Prima Facie* është është shprehje latine që do të thotë, në shikim të parë, një çështje duhet të jetë e qartë nga faktet. Kërkesa e Avokatit të Popullit, në të gjitha pikëpamjet ka qenë e arsyetuar drejtë dhe saktë, ndërsa Gjykata, nuk ka dhënë asnjë sqarim se pse kjo refuzohet “në shikim të parë”.

Pika b) e po të njëjtit paragraf parashihet që “aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”, në rast se Gjykata vendimin e mbështet në këtë pikë atëherë sipas kësaj pike kërkesa e Avokatit të Popullit do të duhej të hudhej, pasi që Dekreti i Presidentes është në pajtim me Kushtetutën dhe se nuk ka shkelje kushtetuese.

Pika c) thotë “Gjykata gjen që parashtruesi i kërkesës nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë”. Thirrja në këtë pikë në rastin tonë nuk mund të bëhet, pasi që sipas nenit 113, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit e ka të garantuar këtë të drejtë.

Pika d) e po të njëjtit paragraf, parashihet që “parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”. Avokati i Popullit në kërkesën e tij ka argumentuar mjaftueshëm pretendimin e tij, dhe në mënyrë të qartë ka specifikuar se ai kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Dekretit të nxjerrur nga Presidentja por jo edhe vlerësimin e kushtetueshmërisë së marrëveshjes ndërkombëtare.³⁷

Sipas dispozitave në të cilat Gjykata është thirrur për të mbështetur Aktvendimin e saj, pra në nenin 29 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, dhe mbështetje të paragrafit (1) c) e të paragrafit (2) të rregullit 36 të Rregullores së punës të Gjykatës, konsiderojmë se asnjë prej kërkesave të këtyre dispozitave nuk janë përmbushur,

³⁷ Shiqo paragrafin, 36 të aktvendimit të Gjykatës ku përcakton se, “Gjithashtu, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pohon se ai është duke sfiduar kushtetutshmerine e Dekretit, por jo edhe kushtetutshmerinë e Marrëveshjes Nderkombetare mbi të eilin bazohet Dekreti.”

që Gjykata të shpallë si të papranueshme kërkesën e IAP. Për më tepër, në aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, bie në sy menjëherë se në arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese ka kundërthënie brenda këtij aktvendimi.

Në paragrafin 34, të Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës thuhet se:

Avokati i Popullit sfidon Dekretin nr. DKGJK-001-2014, të nxjerrë nga Presidentja e Republikës së Kosovës më 31 gusht 2014. Prandaj, parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe ka të drejtë ta referojë këtë çështje në Gjykatë në bazë të nenit 113.2 dhe të nenit 135.4 të Kushtetutës

Nga ky formulim edhe vetë Gjykata konstaton se kërkesa e IAP-së përmbush kriterin që kërkohet për parashtrim të kërkesës në Gjykatë, ndërsa vetë Gjykata, më vonë duke ju referuar edhe nenit 29 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, në të cilën dispozitë është paraparë saktësimi i kërkesës, mbështet aktvendimin e saj për papranueshmërinë e kërkesës së IAP. Gjithashtu, Gjykata, në arsyetimin e vendimit të saj, thirret në paragrafin 2, të rregullit 36, të Rregullorës së Punës, por Gjykata nuk përcakton asnjëherë nga pikat, e këtij paragrafi, e kjo nuk mund të qëndrojë sepse kërkesa e IAP, nuk i ka përmbushur në mënyrë kumulative të gjitha këto që të konsiderohet e pabazuar.

Andaj, sipas dispozitave të rregullores së punës të Gjykatës si dhe Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Gjykata është dashur që kërkesën e Avokatit të Popullit, ta pranojë si kërkesë (çështje) të pranueshme për gjykatën pasi që kërkesa e Avokatit të Popullit i ka plotësuar të gjitha kriteret e parapara me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese. Meqenëse jemi të vetëdijshëm që vendim mbi kërkesën nuk do të mund të merrej (sic do të shpjegojmë më poshtë) deri në vitin 2016 kur do të përfundonte mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë (për herë të dytë) dhe do të zgjidheshin gjyqtarët e rinj – duke mundësuar kështu krijimin e një kuorumi

për vlerësim në lidhje me kërkesën, atëherë është dashur të paktën që Gjykata të dalë me një deklaratë të tillë dhe të tregojë pse nuk mund të vendosë tani mbi kërkesën në fjalë.

Mungesa e kuorunit

Çështjen e kuorunit të Gjykatës do ta shtrojmë si hipotezë, se çfarë do të ndodhte, nëse Gjykata nuk do ta vlerësonte si të papranueshme kërkesën e IAP-së. Gjykata Kushtetuese, për nxjerrjen e vendimeve, si dhe për të vendosur për një çështje, duhet të ketë kuorumin e caktuar, këtë e ka të rregulluar me ligjin për këtë gjykatë.

Neni 19 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton marrjen e vendimeve, e në të thuhet:

1. *Gjykata Kushtetuese vendos si trup gjykues i përbërë prej të gjithë gjyqtarëve të pranishëm të Gjykatës Kushtetuese.*
2. *Gjykata Kushtetuese ka kuorum nëse janë të pranishëm shtatë (7) gjyqtarë.*

Gjykata Kushtetuese e Kosovës për arsye të ndryshme asnjëherë nuk e ka plotësuar numrin prej nëntë Gjyqtarëve siç parashihet me Kushtetuta në nenin 114 par.1, por gjithmonë ka vepruar me 8 gjyqtarë, e nëse këtu shtojmë edhe përjashtimin e gjyqtarit Kadri Kryeziu (shiko rasti K1124/14), atëherë në Gjykatë do të mbeteshin vetëm 7 Gjyqtarë. Gjykata Kushtetuese në momentin e paraqitjes së kërkesës nga avokati i popullit kishte tetë gjyqtarë, 1. Prof. dr. Enver Hasani, 2. Prof. Dr. Ivan Čukalović, 3. Robert Carolan, J.D, 4 Dr. Altay Suroy, 5. Almiro Rodrigues, 6. Prof. Dr. Snezhana Botusharova-Doicheva, 7. Kadri Kryeziu, 8. Arta Rama-Hajrizi.

Për hir të shtjellimit të rastit po supozojmë se Gjykata do ta deklaronte të pranueshme kërkesën e Avokatit të Popullit. Duke pasur në mendje përjashtimin e gjyqtarit Kadri Kryeziut, si dhe përjashtimin e Gjyqtarëve ndërkombëtarë, pasi që Avokati i Popullit në kërkesën e tij atakonte dekretin e Presidentes me të cilin atyre ju ishte vazhduar mandatin në këtë çështje, tre gjyqtarët ndërkombëtarë nuk do të kishin pasur të drejtë të marrin

pjesë në kolegjin gjykues, rrjedhimisht Gjykata Kushtetuese do të mbetet me vetëm katër Gjyqtarë, dhe nuk do të kishte kuorumin e nevojshem të paraparë me nenin 19 par. 2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Pra, sikur të ndodhte që, Gjykata t'a vlerësonte të pranueshme kërkesën e IAP-së, dhe të pranonte të vendoste lidhur me meritat e kësaj kërkesë, Gjykatës do t'i paraqitej problem i kuorunit.

Me vendimin e Gjykatës, për ta vlerësuar të papranueshme kërkesën e Avokatit të Popullit, Gjykata sikur zgjodhi rrugën më të lehtë, ndoshta edhe të vetmen për të larguar topin nga fusha e saj.

Atakimi i Dekretit - jo i marrëveshjes ndërkombëtare

Atakimin e Dekretit e jo të marrëveshjes ndërkombëtare e vërteton edhe vetë Gjykata në paragrafin, 36 të aktvendimit për papranueshmëri ku përcakton se:

Gjithashtu, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pohon se ai është duke sfiduar kushtetutshmërinë e Dekretit, por jo edhe kushtetutshmërinë e Marrëveshjes Nderkombetare mbi të cilin bazohet Dekreti.

Gjykata më tej në paragrafin, 45 të aktvendimit, sikur mundohet ta ndërlidh dekretin me marrëveshjen ndërkombëtare duke thënë se:

Gjykata vëren se argumentet e parashtruesit të kërkesës kryesisht ndërlidhen me përmbajtjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare të lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian nëpërmjet këmbimit të letrave, e ratifikuar nga Kuvendi me 23 prill 2014, edhe pse parashtruesi pohon se ai sfidon vetëm kushtetutshmerinë e Dekretit. Prandaj, parashtruesi nuk e ka mbështetur

pretendimin e tij dhe nuk ka provuar se Dekreti është jokushtetues.

Me këtë Gjykata, pretendon se “parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij dhe nuk ka provuar se Dekreti është jokushtetues”. Po ashtu në këtë paragraf të vendimit të Gjykatës, hetohet një insistim i Gjykatës, që kërkesën e Avokatit të Popullit, ta cilësojë dhe vë karshi apo sfidojë me marrëveshjen ndërkombëtare, përkundër asaj se Avokati i Popullit, shumë qartë bënë të ditur pretendimin e tij dhe saktëson kërkesën, siq është cekur më lartë par. 36 i aktvendimit të Gjykatës.

Gjykata edhe në pikat tjera vazhdon “sikur të ketë vendosur për këtë çështje në mënyrë meritore” e jo aktvendim për papranueshmëri duke duke cekur në paragrafin 47, “sa i përket procedurës së ndjekur nga Presidentja, Gjykata konkludon se Dekreti është në pajtueshmëri me Kushtetuten”, Gjykata në këtë paragraf në një formë mund të themi se është deklaruar sa i përket kushtetutshmërisë së dekretit të Presidentes, Gjykata edhe pse ka marrur një aktvendim për papranueshmëri të kërkesës së Avokatit të Popullit ajo në këtë paragraf, deklarohet sikur të kishte vendosur në mënyrë meritore se dekreti është në pajtueshmëri me Kushtetuten, kjo bie në kundërshtim me aktvendimin për papranueshmëri pasi që Gjykata nuk ka pranuar që këtë çështje ta gjykonte.

Gjykata duke marrë aktvendim për papranueshmëri të kërkesës së Avokatit të Popullit, duke dhënë disa konkluzione, të cilat as për së afërmi nuk i përmbushin standardet e një arsytimi siç do të duhet të ishte, ngase nëse gjykata nuk do ta merr një çështje në gjykim ajo duhet t'i ketë parasysh kriteret të cilat janë paraparë në Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese përkatësisht në rregullin 36 të cekura më lart. Për më tepër Gjykata në mënyrë selektive, ju referohet vetëm atyre pjesëve të kërkesës së IAP-së, për të arsytuar vendimin e saj, edhe pse, aty ku thirret Gjykata, nuk ka asgjë kontestuese.

Në bazë të gjithë asaj që thamë më lartë, vijmë në përfundimin se vazhdimi i mandatit

të tre gjykatësve ndërkombëtarë, me dekret të Presidentes së Republikës së Kosovës, pas përfundimit të mandatit të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, i cili kishte të drejta ekskluzive për emërimin dhe caktimin e mandatit të gjykatësve ndërkombëtarë me dispozitat kalimtare të Republikës së Kosovës dhe pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur ndërkombëtare, dekreti bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, saktësisht me pikën 11 të nenit 65 i cili i garanton Kuvendit të Republikës së Kosovës kompetencën që të propozoj gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese, dhe poashtu bie ndesh me pikën 2 të nenit 114 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila i garanton presidentes të drejtën e emërimit të gjykatësve, me propozimin e Kuvendit të Kosovës.

Poashtu, ekzistimi i amendamentit 13 përmes të cilit ishte shfuqizuar neni 152, i cili i referohej përbërjes së përkohshme të Gjykatës Kushtetuese, përbën qartë ndalesë për të realizuar zgjedhjen e Gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese nga ana e një organizate ndërkombëtare, që do të thotë praktikisht mos-vazhdim i prezencës ndërkombëtare në këtë gjykatë.

Në rastin konkret, vazhdimi i mandatit të tre gjykatësve ndërkombëtarë, edhe pas ndalesave Kushtetuese e kthen Republikën e Kosovës mbrapa edhe në kuptimin politik për shkak të procesit të përmbylljes ndërkombëtare. Anashkalimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me dekret të Presidentes, në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare në formën e letërkëmbimit me Bashkimin Evropian, konsiderojmë se është një gjetje e zgjidhjes për të dalë nga situata politike, e cila në rastin konkret përbën edhe një paafësi institucionale për të konsoliduar institucionet, në këtë rast Gjykatën Kushtetuese, por njëherësh edhe një përshtatje të aktit më të lartë me rrethanat politike.

Logjika e bartjes së kompetencës për emërimin e tre gjykatësve ndërkombëtarë nga letra e presidentes Jahjaga, pretendon t'i delegojë Eulex-it, kompetencën e emërimit të gjykatësve, e jo edhe kompetencën e propozimit të tyre,

e cila kompetencë vijmë në përfundimin se akoma mbetet e garantuar me Kushtetutë si e drejtë ekskluzive e Kuvendit të Republikës së Kosovës. EULEX-i, siaps mandatit të tij, të përcaktuar me Veprimin e Përbashkët, nuk ka asnjë të drejtë të përfshihet në cfardo çështje lidhur me Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, sepse EULEX-i qëndron neutral karshi statusit të Kosovës., këtë ja përcakton korniza ligjore e EULEX-it, e që është Rezoluta 1244, e Kombeve të Bashkuara.

Sa i përket marrëveshjes ndërkombëtare, të realizuar me letërkëmbim, Kushtetuta jonë, njeh qartë epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

Por, megjithatë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, vazhdon të mbetet akti më i lartë juridik, i cili qëndron më lartë se marrëveshjet ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare i nënshtrohen epërsisë së Kushtetutës. Këtë, fakt shumë qartë e përcakton edhe interpretimi i Gjykatës Kushtetuese, në vendimin (KO 95/13), lidhur me kërkesën e deputetit Visar Ymeri dhe të tjerët.

Kërkesa e Avokatit të Popullit, me të cilin sfidoi dekretin e nxjerrë nga Presidentja e Republikës së Kosovës, si parashtrues i kësaj kërkesë, vijmë në përfundimin se IAP, është palë e autorizuar për ta referuar këtë çështje në gjykatë, ngase kjo e drejtë i garantohet me pikën 2 të nenit 113 dhe pikën 4 të nenit 135 të Kushtetutës.

Për më tepër, vijmë në përfundimin se Gjykata Kushtetuese, duke marrë aktvendim për papranueshmëri të kërkesës së Avokatit të Popullit, ka dhënë disa konkluzione pa një arsyetim të mjaftueshëm, për faktin se nëse gjykata nuk do ta merr një çështje në shqyrtim, ajo duhet të ketë parasysh kriteret e përcaktuara me Rregulloren e Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më saktësisht duhet të ketë parasysh nenin 36 të cituar më lartë, të kësaj rregulloreje të punës.

VI. BENCH BARS (TRYEZAT E RRUMBULLAKËTA)

Bench Bars apo ndryshe Tryezat e Rrumbullakëta të organizuara nga Oda e Avokatëve të Kosovës ka dy vite që organizohen, mirëpo këtë vit për të parën herë BIRN ka arritur marrëveshje me Odën e Avokatëve të Kosovës (tash e tutje OAK) që t'i monitorojë ato. Këto tryeza mbledhin rreth vetes avokatë, gjykatës, prokurorë e policë të cilët diskutojnë rreth problemeve me të cilat përballen gjatë zhvillimit të punës së tyre.

Këto tryeza ofrojnë një shembull të mirë të realizimit të po këtij qëllimi, meqenëse shumë prej problemeve të diskutuara gjatë tyre – janë probleme të cilat janë vërejtur edhe gjatë monitorimit të seancave nëpër gjykata, duke filluar nga përfaqësimi zyrtar sipas detyrës zyrtare i avokatëve, lëndët e mbetura në veri të Mitrovicës, raporti i gjykatave me mediat, barazia e palëve në procedurë e të tjera.

Gjatë kësaj periudhe janë monitoruar tryezat e mbajtura në rajonin e Prishtinës, Prizrenit, Gjilanit, Ferizajit, Mitrovicës dhe Gjakovës.

Ekipet tona të cilat kanë monitoruar tryezat e mbajtura, kanë ardhur në përfundim se problemet e diskutuara gjatë këtyre tryezave të rrumbullakëta kryesisht ndryshojnë prej vendit në vend. Si çështje të cilat e dallojnë secilin nga rajonet për nga problemet e diskutura, janë:

- Ferizaj e Gjakova duket të kenë problem me pagesat e avokatëve të angazhuar përmes detyrës zyrtare;
- Gjilani duket të ketë probleme me mënyrën e aplikimit të masës së paraburgimit. Ka raste që për tentim vrasje i pandehuri qëndron në paraburgim vetëm një muaj – ndërkaq ka të pandehur që për raste të kanosjes vuajnë deri në shtatë muaj paraburgim. Duhet theksuar se ky problem është i përbashkët për tërë Kosovën

- Prizreni ka probleme me marrjen e të dhënave për të kaluarën kriminale të të pandehurve dhe me mos-prezencën e të dëmtuarve në të gjitha fazat e procedurës penale. P.sh. ka shumë raste kur të dëmtuarit nuk ftohen fare gjatë shqyrtimit fillestar, edhe pse kjo nuk është në pajtim me ligjet në fuqi;
- Problemi kryesor i diskutuar në tryezën e rrumbullakët të mbajtur në Prishtinë ishte mosmarrja me kohë e aktvendimeve për caktimin e paraburgimit;
- Mitrovica në anën tjetër ka probleme të tjera që kanë të bëjnë me hapësirën e pamjaftueshme për punë e cila pamundëson funksionimin normal të punës së gjyqësorit, lëndët e mbetura në veri dhe pamundësinë e qasjes në to dhe numrin e vogël të gjyqtarëve.

Ndërkaq problemet që duket se janë të përbashkëta për thuajse të gjitha vendet nëpër Kosovë kanë të bëjnë normalisht me Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale. Këto takime kanë evidentuar probleme të mëdha me ofrimin e kundërligjshëm të ndihmës juridike (neni 419 i KPPK). Ky nen në mënyrë eksplicite thekson:

1. *Kushdo që pa autorizim nga një klient siguron asistencë ligjore do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet. 14*
2. *Kushdo që jep ndihmë juridike pa kualifikime, licencimin ose në ndonjë mënyrë tjetër në kundërshtim me ligjin do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*
3. *Kushdo që kryen veprë penale në paragrafët 1 ose 2 të këtij neni për shpërbllim dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.*

4. Për qëllimet e këtij ligji “ndihma juridike” do të definohet siç përcaktohet në Ligjin për Avokatinë

Si pasojë e kësaj duhet të bëhet dicka që të ndryshohet neni 86 i Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe personat që shkelin nenin 419 të KPPK të sillen para drejtësisë.

Procedura me të mitur është parë të jetë pjesë e rëndësishme diskutimesh në mes të akterëve të përmendur më lartë. Raste të mos-përputhjes mes asaj që parasheh Ligji për të Miturit dhe praktikës – janë vërejtur edhe nga monitorimi i BIRN. Këtë problem megjithatë e shtrojnë edhe shumica e tryzave të rrumbullakëta, në të cilat është kërkuar që të miturve duhet tu kushtohet kujdes i vecantë në fazat e procedurës.

Problem tjetër i vërejtur edhe nga monitorimi i BIRN e i shqyrtuar nga ana tjetër e medaljes në tryeza të rrumbullakëta – është edhe shqyrtimi fillestar dhe i dytë në procedurën penale. Megjithatë problemet e paraqitura nga aspekti tjetër (perspektiva e gjyqtarëve, prokurorëve e avokatëve) kanë të bëjnë kryesisht me njoftimin e palës së dëmtuar në të gjitha fazat e procedurës dhe barazinë e armëve. Sipas diskutimeve të bëra në Prizren nga avokatë, gjykatës e prokurorë – është konstatuar se nuk ka barazi të armëve në mes të prokurorit dhe avokatit në paraqitjen e dëshmitarëve në faza.

Monitorimi i BIRN ka raportuar se në 65% të rasteve të monitoruara nuk ka pasur fare gjyqtarë porotë. Në tryezën/at e rrumbullakëta të mbajtura nëpër komunat e Kosovës, është ardhur në përfundim se shkaktar i vështirësive në formimin e kolegjeve prej 3 anëtarëve profesionist është numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve.

Problemët me angazhimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare – janë plotësim i të gjeturave të monitorimit të BIRN. Ky është problem jo i vogël që po i përcjellë proceset gjyqësore, andaj akterët pjesëmarrës në këto tryeza të rrumbullakëta kanë kërkuar që avokatët e angazhuar në polici sipas detyrës zyrtare në mënyrë procedurale të angazhohen edhe në prokurori dhe gjykatë.

Përkundër faktit se janë bërë dy vite prej hyrjes në fuqi të versioneve të reja të KPK dhe KPPK – problem mbetet teknika e gabuar e marrjes në pyetje të palëve.

Një ndër problemet e diskutuara nga gjyqtarët, prokurorët, avokatët e policët e mbledhur në tryezat e rrumbullakëta të mbajtura në Komunat e Kosovës, është edhe cilësimi i gabuar juridik i veprave penale. Ashtu sic edhe u përmend më lartë, kjo është një ndër të gjeturat e monitorimit të gjykatave të cilin BIRN e ka raportuar më herët..

Mos-koordinimi i duhur në mes të prokurorëve dhe gjyqtarëve mbetet një nga problemet që duket se e përcjellë sistemin vit pas viti. Vendimet për zgjatjen e paraburgimit vijnë pak para skadimit të afatit të paraburgimit, gjë që shkakton probleme për gjykatat. Gjithashtu paraqiten raste kur kërkesa prokurorit për vazhdim paraburgimi i dorëzohet gjykatës edhe në momentin e fundit.

VII. VËZHGIMET POZITIVE NGA GJYKATAT

Përkundër faktit se Raporti i Monitorimit të Gjykatave sjell të meta që hasen gjatë monitorimit dhe u jep vëmendje atyre për shkak të përmirësimit të nevojshëm, monitoruesit e BIRN ndajnë edhe shumë të mira që vijnë nga sistemi i gjykatave e të cilat duhet përmendur.

PRISHTINË: Ne Gjykatën Themelore në Prishtinë dega në Lipjan gjyqtarët kryesisht janë të hapur për pyetjet dhe kërkesat e BIRN si për xhirim ashtu edhe për marrje të shkresave të lëndëve. Karakteristikë tjetër që vlen të përmendet është fakti që Gjykata e Apelit në Prishtinë i dërgon për një muaj planet e zhvillimit të seancave, gjë që lehtëson shumë punën e monitoruesve të BIRN.

PRIZREN: Në të gjitha seancat e monitoruara – monitoruesve të BIRN u mundësohet një kopje e procesverbalit dhe kurdo që ka nevojë për marrjen e dosjes së lëndës (aktakuza, aktgjykime) – këto të fundit u janë siguruar monitoruesve të BIRN.

MITROVICË: Përderisa kushtet në Gjykatën e Mitrovicës dega në Vushtri, kushtet janë jo shumë të mira dhe ka probleme të shumta, duhet cekur se në veri të Mitrovicës në seancat e EULEX-it është ndryshe, ka mirëkuptim edhe për xhirime edhe për bashkëpunim në mes të monitoruesve të BIRN dhe komunikim të drejtë.

FERIZAJ: Në Gjykatën Themelore në Ferizaj është për t'u lavdëruar fakti që pothuajse në të gjitha situatat kur u është kërkuar informacion kanë qenë të qasshëm për monitoruesit e BIRN, duke ua mundësuar qasjen në dokumentet e nevojitura. Poashtu, Gjykata Themelore në Ferizaj, më konkretisht Zyra për informim është një prej Gjykatave të rralla që është shumë e kujdesshme lidhur me orarin e gjykimeve dhe gjithmonë i dërgon në fillim të muajit. Gjithashtu edhe gjyqtarët

janë shumë bashkëpunues dhe u kanë krijuar monitoruesve të BIRN shumë lehtësira, duke qenë në të shumtën e rasteve të gatshëm të deklarohen për të gjitha çështjet që hyjnë në fushëveprimin e punës së monitoruesve të BIRN.

PEJË: E mira në Gjykatën Themelore të Pejës është së si gjyqtarët e po ashtu edhe stafi tjetër janë shumë transparentë, dhe i ofrojnë të gjitha dokumentet te cilat i kërkojnë monitoruesit e BIRN, duke filluar nga procesverbalet, aktvendimet dhe aktgjykimet. Po ashtu shumica e gjyqtarëve në këtë Gjykatë ta ofrojnë mundësinë për të xhiruar. Po ashtu edhe degët e kësaj Gjykate të ofrojnë këtë mundësi.

GJAKOVË: Në Gjykatën Themelore në Gjakovë bashkëpunimi ka qenë në rritje gjatë këtij viti. Monitoruesit e BIRN kanë pasur qasje në seanca dhe në marrjen e procesverbaleve të lëndëve. Gjithashtu vlen të theksohet edhe gatishmëria e gjykatësve dhe trupave gjykues për bashkëpunim me palët e dëmtuara për caktimin e seancave.

GJILAN: Ajo që vlen të theksohet për Gjykatën në Gjilan është fakti që Gjilani cdo muaj e dërgon orarin e seancave dhe bashkëpunimi me monitoruesit e BIRN është në nivel shumë të kënaqshëm.

Siç mund të vërehet nga ajo që u tha më sipër, bashkëpunimi në përgjithësi në mes të gjykatave dhe monitoruesve të BIRN është shumë i kënaqshëm, megjithatë duhet theksuar se ky bashkëpunim vjen si pasojë e një pune kolosale dhe të gjatë të monitoruesve të BIRN dhe të gjyqtarëve për vendosjen e raporteve që ekzistojnë tani.

VIII. APLIKIMI I REKOMANDIMEVE NGA VITI I KALUAR

Parlamenti i Kosovës » Parlamenti i Kosovës duhet të procedojë dhe aprovtojë Ligjin për Kundërvajtjet dhe atë për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor- **është në procedim e sipër** Komisioni parlamentar për legjislacionin e gjyqësi, duhet të monitorojë zbatimin e legjislacionit gjyqësor.

Qeveria e Kosovës: » Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë buxhet të mjaftueshëm në përputhje me kërkesat e KGJK-së- **ende nuk është realizuar.**

Ministria e Drejtësisë duhet të amandamentojë dhe drafttojë Ligjin për Kundërvajtjet dhe atë për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor; **në realizim e sipër**

Ministria e Drejtësisë duhet të marrë parasysh propozimet e BIRN-it për Ligjin për Kundërvajtjet dhe të atij për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor; **në realizim e sipër**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës: » KGJK-ja duhet të rrisë numrin e gjykatësve në të gjitha nivelet e gjykatave; **Numri i gjyqtareve me date 31.12.2014 në të gjitha nivelet e gjykatave të Republikës së Kosovës ka qenë 317 gjyqtar. Në këtë numër janë të përfshirë edhe 11 gjyqtar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme. Tani, në muajin shkurt 2015 numri i gjyqtareve në të gjitha nivelet e gjykatave është 316. Ky numër nuk është i mjaftueshëm sipas nevojave të gjykatave. Me buxhetin mbi gjykatat janë të paraparë 404 gjyqtarë (përfshirë këtu edhe 12 gjyqtarë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme). Aktualisht në procedurë të rekrutimit janë rreth 40 gjyqtarë që besohet se shumë shpejtë do të fillojnë punën në Gjykatat e Republikës së Kosovës.**

KGJK-ja duhet të ndërmarrë masat e nevojshme ndaj gjykatësve që shkelin të drejtat

procedurale të palëve; » **Zyra e Prokurorit Disiplinor është kompetente sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësorë të nisë procedurat ndaj gjykatësve që shkelin kodin e etikës, apo të drejtat procedurale të palëve, ndërsa KGJK – ja, ka Komisionin Disiplinor që ndërmerr masat të cilat janë të parapara me ligj, andaj, në vazhdimësi janë duke u trajtuar këto raste në mekanizmat përkatës.**

KGJK-jaduhettërrisënumrinebashkëpunëtorëve profesionalë, të trajtuar në këtë raport; » **Rritja e numrit të Bashkëpunëtorëve Profesional është e pamundur për shkak të kufizimeve buxhetore.**

KGJK-ja duhet të bashkëpunojë me Ministrinë e Drejtësisë rreth draftimit të Ligjit për Kundërvajtjet; » **Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është duke bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë për draft Ligjin në fjalë, në komision janë caktuar gjyqtar të cilët kryesisht punojnë në këtë lëmi.**

KGJK-ja do të duhej të sigurohet për nxjerrjen e udhëzimeve konkrete të cilat obligojnë gjykatën që të caktojë shqyrtimin gjyqësor në momentin kur pala e dorëzon ankesën për tiketën në trafik; » **Edhe kjo çështje pritet të rregullohet në draft Ligjin për Kundërvajtje pasi që sipas rregullave të tanishme divizioni i kundërvajtjeve është i stërngarkuar dhe është e pamundur të procedohen të gjitha rastet. Me ligjin e ri do të rregullohet procedura që gjykatat të jenë më efikase kështu që këtë çështje duhet ta rregulloj ligji, e jo ndonjë udhëzim i KGJK-së.**

KGJK-ja sigurohet që të rriten tarifat për paraqitjen e ankesës për kundërvajtje; » **Gjithashtu, edhe kjo çështje pritet të rregullohet në Ligjin për Kundërvajtje.**

KGJK-ja sigurohet që paushalli gjyqësor të llogaritet konform shpenzimeve të gjykatës e jo siç është tani në shumën prej 5 eurosh; Po, varësisht nga rritja e shpenzimeve është duke u rritur edhe paushalli.

KGJK-ja sigurohet që t'i futë në lëndë prioritare ankesat për gjokat të cilat janë shqiptuar ndaj shtetasve të huaj dhe qytetarëve të Kosovës të cilët ngasin makina me regjistrimet e huaja (mërgimtarët); » **Është prioritet kjo çështje për shtetasit e huaj dhe emigrant, andaj nuk është duke pasur pengesa në këtë drejtim.**

KGJK-ja duhet të kujdeset për respektimin e marrëveshjes me OAK-un për caktimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare; » **KGJK dhe OAK janë duke bashkëpunuar për respektimit të marrëveshjes, ka disa probleme por mënyra e caktimit të avokatëve sipas detyrës zyrtare është duke u përmirësuar dhe ka arritje konkrete në shumë gjykata të vendit.**

KGJK-ja duhet të sigurohet që të gjitha gjykatat me degët përkatëse, të lajmërojnë shqyrtimet publike; » **KGJK ka siguruar monitorët nëpër të gjitha gjykatat, tani ka emëruar edhe shumicën e zyrtarëve për informim e të cilët e kanë për detyrë mbikëqyrjen e publikimit të këtyre orareve.**

KGJK-ja duhet të sigurohet për fillimet me kohë të shqyrtimeve gjyqësore kur kjo është e mundur dhe të marrë masa për gjykatësit që zvarrisin dhe nuk fillojnë më kohë shqyrtimet; » **Fillimi me kohë i shqyrtimeve gjyqësore për KGJK është i rëndësishëm për shkak të ngritjes së besimit, janë duke u vlerësuar raportet në vazhdimësi dhe KGJK është në përpjekje të vazhdueshme që edhe kjo çështje të përmirësohet.**

KGJK-ja duhet të kujdeset që gjykatat dhe degët përkatëse, të mbajnë gjykimet në sallat e gjykimeve në rastet kur sallat janë të lira dhe shfrytëzueshme. » **Tani në shumicën e ndërtesave të gjykatave ekzistojnë gjykatat model nëpër të cilat ka salla të gjykimit e që konsiderojmë se janë të mjaftueshme, kështu që nuk ka nevojë të mbahen gjykime nëpër zyrrat e gjyqtareve dhe tani së fundmi hyrja në**

Pallatin e Drejtësisë e që është një ndërtesë me standarde evropiane është mundësuar që gjykimet të mbahen në sallat e gjykimeve.

KGJK-ja duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për mospërdorimin e telefonave brenda objektit të gjykatës; » **Ka përmirësim sepse këtë vit është përdorur vetëm në 7 % ndërsa vitin e kaluar ka qenë 13%**

KGJK-ja duhet të kujdeset për respektimin e kodit të uniformës në shqyrtimet gjyqësore; » **është respektuar gati 100 %, sepse këtë vit është nuk është përdorur vetëm në 4 % të rasteve ndërsa vitin paraprak ka qenë mospërdorimi në 34 %**

KGJK-ja duhet të sigurojë që seancat gjyqësore të mbahen në sallat e gjykimeve, atëherë kur kjo është e mundur; » **Ka përmirësim nga viti paraprak**

KGJK-ja duhet të sigurojë që pranë secilës gjykatë të funksionojë sistemi i lajmërimit të gjykimeve në tabelën e shpalljeve; » **është realizuar përveç në Pejë**

KGJK-ja duhet të sigurojë përkthim adekuat për palët në procedurë në shqyrtimet gjyqësore që ka nevojë; » **ka mangësi, edhe këtë vit ka pas raste kur nuk ka mund të sigurohet përkthyesi në gjykata.**

KGJK-ja duhet të kujdeset për aktivizimin dhe respektimin e sistemit të audio dhe video-incizimit të seancave gjyqësore. **Nuk është realizuar sa duhet. Në 85% të rasteve të monitoruara nuk është përdorur audio dhe video- incizimi.**

Këshilli Prokurorial i Kosovës: Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) duhet të rrisë numrin e prokurorëve në të gjitha nivelet; **ende nuk është realizuar.**

KPK-ja duhet të respektojë marrëveshjen e lidhur me OAK-un, e cila ka të bëjë me angazhimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare në procedurat paraprake; » **ka filluar të respektohet këtë vit.**

KPK-ja duhet të sigurojë transparencë më të lartë të prokurorëve dhe gatishmëri të tyre për të qenë më komunikativë ndaj mediave dhe qytetarëve, gjithmonë duke mos i rrezikuar hetimet dhe proceset gjyqësore; » **nuk është realizuar. Prokurorët fare nuk janë transparentë.**

KPK-ja duhet të marrë masa ndaj prokurorëve që vonohen në shqyrtimet gjyqësore; **nuk është realizuar.**

Gjykata Supreme: Gjykata Supreme e Kosovës duhet të sigurohet për sqarimin dhe interpretimin e drejtë të dispozitave penale dhe procedurale penale. » **në realizim e sipër**

Gjykata e Apelit: Gjykata e Apelit duhet të trajtojë me radhë lëndët, sipas datave të pranimit; **sërisht ka vonesa**

Gjykata e Apelit nuk duhet të vonojë trajtimin e lëndëve në procedim; **Është duke u bërë përpjekje e madhe për përmirësimin e mëtejshëm**

Gjykatat/ Gjykatësit: Gjykatësit duhet të respektojnë dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që kanë të bëjnë me radhën e marrjes në pyetje të palëve në shqyrtim; » **është realizuar- nuk kemi pasur ndonjë rast këtë vit**

Gjykatësit duhet të respektojnë dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që kanë të bëjnë me fjalën hyrëse sipas radhës; » **është realizuar**

Gjykatësit duhet të respektojnë dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që kanë të bëjnë me leximin e të drejtave dhe obligimeve të palëve në shqyrtim; » **nuk është realizuar sa duhet**

Gjykatësit duhet të respektojnë dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që kanë të bëjnë me leximin e deklaratës së betimit për dëshmitarët; » **nuk është realizuar**

Gjykatësit duhet të respektojnë marrëveshjet e OAK-ut me KGJK-në dhe KPK-në me rastin e caktimit të avokatëve sipas detyrës zyrtare; » **është realizuar**

Kryetarët e gjykatave dhe përgjegjësit e degëve, duhet të sigurohen për lajmërimin e shqyrtimeve gjyqësore publike; » **është realizuar përmes monitorëve që janë të vendosur nëpër gjykata.**

Kryetarët e gjykatave duhet të sigurohen për përdorimin e sallave të gjykimeve kur ekzistojnë mundësitë për këtë; » **nuk është realizuar sa duhet**

Kryetari i trupit gjykues/gjykatësi i çështjes nuk duhet të përdorë telefonin celular gjatë shqyrtimit gjyqësor; » **nuk është realizuar, ngase nga 6% i totalit të përdorimit të telefonave, 2% prej tyre e përbëjnë përdorimin e telefonave nga gjykatësit/trupi gjykues.**

Kryetari i trupit gjykues/gjykatësi i çështjes duhet të sigurojë mbarëvajtjen e shqyrtimit gjyqësor duke mos lejuar përdorimin e telefonit gjatë shqyrtimit gjyqësor nga palët dhe pjesëmarrësit tjerë në gjykim; **e realizuar- mirëpo jo sa duhet**

Policia e Kosovës:

Ligji për kundervajtjet është duke u hartuar edhe një pjesë e këtyre rekomandimeve kemi informata se janë futur në të. Ligji pritet të shkojë në Kuvend gjatë këtij viti.

Policia e Kosovës duhet të krijojë një bazë të të dhënave ku do regjistroheshin gjambat e shqiptuara në trafik; »

Policia e Kosovës duhet të hartojë formën e tiketës së trafikut në të cilën palët udhëzohen për të drejtën e ankesës; »

Policia e Kosovës duhet të sigurohet që kundërvajtësit në trafik ta kenë kuptuar se brenda tetë (8) ditësh gjoba do marrë formën e prerë nëse e njëjta nuk do animohej; »

Policia e Kosovës duhet të caktojë zyrtarët kompetent të cilët i regjistrojnë gjambat në bazën e të dhënave.

Oda e Avokatëve të Kosovës: » Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK) duhet të krijojë mekanizmat

e duhur për angazhimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare; » **e ka realizuar përmes Vendimeve të nxjerra**

OAK-u duhet të kujdeset për respektimin e Vendimeve për angazhimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare; » **Këtë vit kanë nisur të respektohen vendimet por akoma s'janë në nivel të kënaqshëm**

OAK-u duhet të kujdeset për funksionimin e Odave Regjionale me rastin e caktimit të avokatëve sipas detyrës zyrtare; **ka pasur përmirësime të dukshme këtë vit**

A. Zbatimi i masave alternative për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale

BIRN, gjatë monitorimit të vitit 2014 ka vërejtur se masa më e shpeshtë e caktuar për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë është caktimi i masës së paraburgimit.

Edhe përkundër faktit që masa e paraburgimit edhe në Kodin e Procedurës Penale parashihet si masa e fundit dhe më e rënda për sigurinë e të pandehurit, ngase kemi të bëjmë me kufizimin e lirisë së personit, e drejtë kjo e garantuar edhe me Konventën për mbrojtjen e të Drejtat të Njeriut dhe Lirive Themelore³⁸, gjykatat tona në praktikë më së shpeshti e aplikojnë këtë masë.

Përveq masës së paraburgimit Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, parashih edhe tetë masa të tjera³⁹. Njëra nga masat që shumë rrallë apo fare nuk aplikohet, është masa e sigurisë së të pandehurit përmes Dorëzarisë.

Dorëzania caktohet zakonisht në të holla dhe kjo duhet të bëhet duke u bazuar në peshën

e veprës penale, e poashtu edhe në gjendjen materiale të personit që e jep dorëzaninë, marrë parasysh këtë fakt aplikimi i kësaj mase do ta prekte secilin person njësoj, nga ana tjetër do ta kursente shtetin nga shpenzimet për mbajtjen e një personi në paraburgim, të cilat llogariten të jenë rreth 30 euro në ditë.

Poashtu aplikimi i masës së dorëzarisë, mundëson edhe konfiskimin e përkohshëm të dokumentit të udhëtimit personit që jep dorëzaninë dhe kjo konsiderojmë se është njëra nga masat shumë adekuate për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë, e cila masë në praktikë shumë rrallë aplikohet.

Marrë parasysh faktin që në vendin tonë kryhen vepra penale edhe nga shtetasit e huaj, aplikimi i masës së dorëzarisë për sigurinë e prezencës së këtyre të pandehurve është njëra nga masat më adekuate, ngase me lënjen në dorëzani qoftë të hollave, letrave me vlerë, apo pasuri tjera të luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat lehtë mund të shndërrohen në para në rast se i pandehuri ik, me aktvendim të gjykatës mund të caktohet që vlera e dhënë si dorëzani të derdhet në fondin për kompenzimin e viktimave.

Monitoruesit e BIRN gjatë monitorimit të seancave përgjatë këtij viti kanë vlerësuar se aplikimi i shpeshtë i masës së paraburgimit është shqetësim i madh edhe për politikën ndëshkimore të sistemit gjyqësor në Kosovë dhe kjo problematikë duhet të adresohet sa më parë nga akterët e drejtësisë në mënyrë që të aplikohet në praktikë edhe përdorimi i masave tjera për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë, e në vecanti masa e dorëzarisë.

Si pasojë e kësaj të gjeture, vitin që vjen, njëri nga fokuset e Raportit të Monitorimit të Gjykatave do të jenë specifikisht rastet e paraburgimit.

38 eni 5 Konventën për mbrojtjen e të Drejtat të Njeriut dhe Lirive Themelore, Rome 4.XI.1950

39 Neni 173 i KPPK-së

IX. REKOMANDIME dhe FALËNDERIME

1. KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS

- Të formohen kushtet për funksionimin e departamentit të veçantë për prokurorë për të mitur
- Ofrim i trajnimeve shtesë për prokurorë për mënyrën e marrjes në pyetje me Kodet e reja që ndërlidhen me pyetjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta
- Përmirësimi i familjarizimit të prokurorëve me lëndët paraprakisht
- T'u ipet rëndësi dhe kujdes më i madh lëndëve të korrupsionit
- Të investohet në insitutin e negociimit
- Të sigurohen bashkëpunëtorë profesional për prokurorët
- Të ofrojë transportin e punëtorëve të KPK-së në Pallatin e Drejtësisë
- Të rrisë numrin e prokurorëve
- Të miratojë buxhet të vecantë për dizajnimin dhe blerjen e uniformave për prokurorët
- Krijimin e mekanizmave të cilët do i thërrasit në përgjegjësi prokurorët të cilët nuk shkojnë me kohë në seanca gjyqësore
- Krijimi i një mekanizmi zyrtar të incizimit të bisedave telefonike në mes zyrtarëve policorë dhe prokurorisë së shtetit.
- Shtimi i kontrollit për mbrojtësit e viktimave dhe kërkimi i përgjegjësive nga ta në rastet kur dështojnë t'i mbrojnë viktimat.
- Tani që EULEX nuk do të marrë më raste të reja, dhe përgjegjësitë për këtë do të kalojnë tek Prokuroria Speciale – duhet që të rritet numri i prokurorëve në këtë Prokurori

2. KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

- Të rritet numri i gjyqtarëve
- Ofrim i trajnimeve shtesë për gjyqtarë për mënyrën e marrjes në pyetje me Kodet e reja që ndërlidhen me pyetjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta
- Futja në përdorim e ueb-faqeve për lajmërimin e seancave – digjitalizimi i gjykatave
- Ndërmarrja e masave disiplinore nga KGJK kur shkaktohen vonesa të fillimit të seancave nga trupi gjyqësor
- Të investohet në insitutin e negociimit dhe të ndërmjetësimit
- Digjitalizimi i administratës
- T'u ipet rëndësi dhe kujdes më i madh lëndëve të korrupsionit
- Ridestiminin e personelit të administratës
- Kontraktimin e shërbimeve të sigurimit fizik të gjykatave
- Paisjen e gjykatësve me Lap top.
- Angazhimin e bashkëpunëtorëve profesional për gjykatësit
- Angazhimin e praktikantëve me pagesë në gjykatë
- Krijimin e një databaze unike të regjistrimit të të kaluarës kriminale.
- Të obligojë Gjykatën Themelore të Prishtinës që të rekrutojë zëdhënës

3. MINISTRIA E DREJTËSISË

- Rregullimi i paqartësive tek personat e paautorizuar për përfaqësim ligjor sipas Kodit Penal

- Të bëhet kthimi i padisë subsidiare në kodin e ri penal
- Përshpejtimi i procedurave në ofrimin e Ndihmës Juridike Ndërkombëtare
- Sigurimin e transportit të rregullt për të dënuarit nga qendrat korrektuese në gjykatore dhe prokurori dhe anasjelltas.

4. ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS

- Rregullimi i paqartësive tek personat e paautorizuar për përfaqësim ligjor sipas Kodit Penal
- Profilizimi më i shpejtë i avokatëve
- Ofrimi i trajnimeve shitesë për teknikat e marrjes në pyetje për avokatë
- Aplikimi më i mirë i sistemit i cili ndalon avokatët e caktuar sipas detyrës zyrtare t'i angazhojnë avokatët e tjerë pa lejen e Odës
- Pezullimi i licencave për avokatët e dënuar

5. EULEX

- Kontaktimi me gjyqtarët e EULEX është i pamundur pas seancave. Të bëhet dicka në lidhje me këtë.
- Angazhimi më i madh i prokurorëve lokal në më shumë raste me të cilat merret EULEX-i

6. POLICIA E KOSOVËS

- Përmirësimi i organizimit të transportit të të pandehurve dhe avokatëve nga Jugu në Veriun e Mitrovicës
- T'u ipet rëndësi dhe kujdes më i madh lëndëve të korrupsionit-
- T'u ipet prioritet realizimit të urdhëresave të gjykatës
- T'u ipet prioritet realizimit të urdhëresave të prokurorisë

- Krijimi i një mekanizmi zyrtar të incizimit të bisedave telefonike në mes zyrtarëve policorë dhe prokurorisë së shtetit

7. PARLAMENTI I KOSOVËS

- Harmonizimi urgjent i kodit të drejtësisë për të mitur me KP dhe KPPK
- Kthimi i padisë subsidiare në kodin e ri penal
- Rritja e menjëherëshme e buxhetit për Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial

8. GJYKATAT

- Kujdes më të madh lëndëve të korrupsionit
- Digjitalizimi i administratës
- Të mos caktohen nga 3-4 seanca gjyqësore në të njëjtën ditë për një gjykatës pa pasur koordinim të duhur të kohës
- Të kihet kujdes në vendin e mbajtjes së seancave në rastet e veprave penale të rënda si p.sh. vrasje. Hapësira gjatë këtyre seancave duhet të jetë më e madhe – e të mos lejohet që seancat e tilla të mbahen nëpër zyre të gjyqtarëve ku distanca në mes të të akuzuarit dhe prokurorit nuk mund të jetë as gjysmë metri.
- Ndërmarrja e masave në lidhje me shtyerjen e seancave të rasteve të korrupsionit në distancë të madhe kohore nga njëra-tjetra
- Mos-caktimi i seancave gjyqësore me prokurorë të njëjtë – në termine të njëjta

9. PROKURORIA E SHETIT

- Zgjedhja e kryeprokurorit
- Sigurimi i prezencës së prokurorëve në sallat e gjykimit konform një plani të hartuar në bashkëpunim me gjykatat

- Kujdesi i shtuar i prokurorëve gjatë mbarvajtjes së procesit gjyqësor
- Mbajtja e uniformave nga prokurorët
- Komunikimi i saktë dhe i drejtë në mes prokurorit dhe policisë.
- Kujdes i shtuar në ruajtjen e dosjeve me materiale konfidenciale
- Kujdes i shtuar gjatë ruajtjes së materialeve të siguruara nga përgjimet telefonike dhe zbatimi i masave të fshehta të vëzhgimit.
- Dalja më e shpeshtë e prokurorit në vendin e ngjarjes.
- Kujdesi me përpilimin brenda afatit të kërkesave për sekuestrimin e pasurive të përfituara në mënyrë të kundërligjshme

10. ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR

- Nisjen e procedurave disiplinore për gjykatës dhe prokurorë të cilët është konstatuar në këtë raport se kanë kryer shkelje të procedurave dhe kodit të etikës
- Krijimin e mekanizmave të cilët sigurojnë një mbikqyrje më të mirë të sistemit të drejtësisë nga ZPD
- Shtimin e numrit të rasteve të cilat inicohen ex Officio nga zyra e prokurorit disiplinor

BIRN ka kënaqësinë të shpreh falenderimet e veta për të gjithë pjesëmarrësit të cilët morën pjesë në diskutime në tryezën e diskutimit të draft-raportit dhe ofruan qëndrimet e tyre në të gjeturat e monitorimit dhe ishin të hapur për të diskutuar çështjet e hasura në këtë proces.

RAPORTI I MONITORIMIT TË GJYKATAVE

2014

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese - BIRN (Kosovë)

"Mensa e Studenteve" Kati i parë,
Prishtinë 10 000, Kosovë
Website: www.kosovo.birn.eu.com
www.internewskosova.org
Email: kosova@birn.eu.com
info@internewskosova.org



Ky projekt financohet dhe merxhohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë dhe implementohet nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese.

Dizajni nga:
project.GRAPHICS